



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 09:30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara dhe buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në projektbuxhetin e vitit 2020.
2. Seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara dhe buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në projektbuxhetin e vitit 2020.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Antoneta Dhima, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Sadi Vorpsi

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Ylli Shehu.

Të ftuar:

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

1. znj. Ogerta Manastirliu, Minister
2. znj. Gelardina Prodrani, Sekretar i Përgjithshëm
3. znj. Rudina Degjoni, Drejtor i Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor
4. z. Saimir Kadiu, Drejtor i buxhetit dhe menaxhimit financiar
5. znj. Denada Seferi, Drejtor i programeve të zhvillimit të shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

1. znj. Besa Shahini Minister
2. Oltjon Muzaka, Sekretar I Përgjithshëm
3. znj. Mirela Bimo, Drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar
4. z. Eridon Kotrri, Këshilltar

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

Sot në rendin e ditës do të zhvillojmë një seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara dhe buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në projektbuxhetin e vitit 2020.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi një seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara për buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në projektbuxhetin e vitit 2020. Më pas kemi shqyrtimin në parim të raporteve.

Fillojmë me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Zonja Manastirliu, mirë se keni ardhur!

Gjithashtu, mirë se keni ardhur zonja Geraldina, zonja Rudina, zoti Sajmir dhe zonja Denada!

Fjalën e ka ministrja dhe më pas do të vazhdojmë me pyetje, nëse do të ketë.

Ogerta Manastirliu – Mirëmëngjesi!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni të bëj një pasqyrë sintetike të projektbuxhetit për vitin 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Që në fillim të fjalës sime dua të them se ky buxhet është buxheti i qytetarëve, i cili do të mbështesë më shumë grupet në nevojë, kategoritë më vulnerabël, do të ulë pabarazitë dhe do të sigurojë më shumë akses dhe shërbime cilësore në objektivin tonë madhor të mbulimit shëndetësor universal për të dyja sektorët që mbulon ministria që unë drejtoj, pra për sektorin e mbrojtjes sociale dhe atë të shëndetësisë.

Buxheti për vitin 2020 parashikohet të jetë 77 miliardë e 735 milionë lekë ose 14% të PBB-së apo 14,6%, përkundrejt buxhetit të shtetit për të dyja sektorët. Buxheti i vitit 2019-2020 ka një rritje me 4%, krahasuar me 2019 apo në vlerë absolute 2 miliardë e 98 milionë lekë për të dyja sektorët.

Në fillim, dua të ndalem në sektorin e mbrojtjes sociale. Duke marrë në konsideratë të gjitha përpjekjet që janë bërë në këta vjet me parimet e solidaritetit, universalitetit, uljes së pabarazive, na kanë sjellë sot në një konsolidim të programeve tona të mbrojtjes sociale, duke vijuar të mbështesim pikërisht skemat, të cilat mbrojnë familjet që janë në vështirësi ekonomike, mbrojnë grupet vulnerabël dhe, sigurisht, sigurojnë mirëqenie për ta. Dua të ndalem këtu te konsolidimi i programeve, të cilat janë bërë pjesë e reformave në këta 5 vjet, siç është programi i ndihmës ekonomike, një skemë tashmë e konsoliduar, një reformë që mbështet më shumë persona, të cilët janë në kufirin e varfërisë. Këtu dua të them se jo vetëm buxheti për vitin 2020 do të mbështesë, por, gjithashtu, do të sigurojë që më shumë persona të përfshihen, duke ecur në parimin e solidaritetit dhe universalitetit të skemës. Përfituesit do të jenë më shumë se 66 mijë, të cilët do të mbështeten me 4,5 miliardë lekë nga buxheti i vitit 2020. Ne do të ecim me një reformë, e cila është ndërmarrë tashmë prej 3 vjetësh nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale dhe nga qeveria shqiptare, në bashkëpunim me Bankën Botërore për pagesat e personave me aftësi të kufizuar, ku, përveç Tiranës, në vitin 2020 në një vlerësim të ri biopsikosocial për personat në nevojë do të përfshihet edhe Durrësi, edhe Elbasani. Pra, do të jenë më shumë se 16 miliardë lekë të dedikuara për mbështetjen e më shumë se 166 mijë personave me aftësi të kufizuara. Për herë të parë në këto tri qarqe ku do të shtrihet skema kemi përfshirë edhe kategori, të cilat nuk kanë qenë ndonjëherë të përfshira në mbështetjen me pagesa *cash* për aftësinë e kufizuar, siç janë fëmijët nga 0 deri në 2 vjeç. Gjithashtu, edhe fëmijët me aftësi ndryshe deri në moshën 18 vjeç do të përfitojnë në kuadër të vlerësimit të ri biopsikosociale pagesat 100% nga skema e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu, do të kemi pjesë të mbështetjes direkt nëpërmjet këtyre pagesave të rreth 4500 të pasiguarve, të cilët janë përfshirë në këtë skemë në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet ndryshimeve të fundit ligjore të ndodhura në ligjin “Për asistencën sociale”. Pra, do të vijojmë të konsolidojmë politikën e re, të cilën e kemi përfshirë në vitin 2019 të bonusit të bebes, ku më shumë se 30 mijë të porsalindur janë mbështetur gjatë vitit 2019 nëpërmjet programit të bonusit, një program, i cili do të vijojë në vitin 2020. Mbështetja financiare që do t’u dedikohet, është 2 miliardë lekë, të cilat do të shkojnë direkt në buxhet e familjeve, pasi është një ndër programet

me qasje direkte universale, e cila nuk shërben vetëm si një politikë pronataliste, efektet e së cilës, sigurisht, nuk mund të ndihen vitin e parë, por, mbi të gjitha, shërben si një program i mbrojtjes sociale, pasi mbështet familjet e reja dhe fëmijët.

Në kuadër të instrumenteve të reja që buxheti i vitit 2020 do të mbështesë janë, gjithashtu, edhe 2 instrumente financiare në funksion të mbështetjes së shërbimeve sociale dhe në funksion të punësimit të kategorive në nevojë. Qoftë fondi social, qoftë ndërmarrjet sociale janë dy instrumentet e reja që do të na garantojnë në vitin 2020 më shumë shërbime sociale për kategoritë në nevojë, për fëmijët me aftësi të kufizuar, për të moshuarit, si dhe për gratë në nevojë. Gjithashtu, do të kemi mundësi që programet sociale, që tashmë kemi, t'i alternojmë në programet e punësimit të qëndrueshëm. Pra, programi i ndërmarrjes sociale që do të buxhetohet për vitin 2020, do të mundësojë punësimin e kategorive në nevojë.

Në mënyrë sintetike dua të ndalem në buxhetin për shëndetësinë, i cili synon rritjen e aksesit të shërbimeve shëndetësore me synim uljen e shpenzimeve nga qytetarët. Sigurisht që sfida është edhe përmirësimi i aksesit, por ajo çfarë ne kemi bërë në këta 6 vjet ka siguruar që më shumë qytetarë të marrin shërbime, që më shumë grupe të pafavorizuara të aksesojnë shërbimin shëndetësor në qytet dhe në fshat nëpërmjet programeve tona që tashmë janë të konsoliduara.

Buxheti i shëndetësisë për vitin 2020 parashikohet të jetë 52 miliardë e 675 milionë lekë, apo 9,99% përkundrejt buxhetit të shtetit dhe 2,94% përkundrejt PBB-së. Ndoshta kjo rritje nuk do t'i përmbushë 100% pritshmëritë e qytetarëve, sepse çdo ditë e më shumë ne shikojmë që qytetarët kanë më shumë pritshmëri për shërbimet shëndetësore, për infrastrukturë më të mirë në spitale, për infrastrukturë më mirë në qendrat shëndetësore, kërkojnë më shumë akses në kujdesin paraspitalor, por më e rëndësishme është se çdo ditë ne po garantojmë akses si në qytet, ashtu edhe në zonat rurale për ato kategori, të cilat kanë qenë të pavorizuara deri dje dhe nuk kanë marrë shërbime shëndetësore. Si është garantuar kjo? Dua të përmend këtu që programet e parandalimit, si në çdo sistem shëndetësor, janë guri i themelit për të garantuar kujdesin shëndetësor, ndaj me buxhetin e vitit 2020 ne do të vijojmë të financojmë programet e kontrollit mjekësor falas për 475 mijë qytetarë të moshave 35-704 vjeç. Gjithashtu, do t'u garantojmë 240 mijë fëmijëve vaksinat falas, duke përmendur këtu edhe vaksinat e reja që kemi përfshirë, qoftë vaksinimin e fëmijëve për rotavirusin, gjithashtu edhe për vaksinën e gripit për kategoritë e riskuara. Gjithashtu, do t'u sigurojmë mbi 70 mijë grave testimin falas për "Human Papilloma Virus", për depistimin apo parandalimin të kancerit të qafës së mitrës, si dhe për herë të parë me një program kombëtar për depistimin e hershëm dhe kontrollin e kancerit të gjirit me buxhetin e

vitit 2020 do t'u sigurojmë mbi 20 grave ekzaminimin falas të mamografive. Kjo do të bëhet e mundur nëpërmjet investimeve që ne do të kryejmë në të gjitha spitalet rajonale për të pasur në çdo spital rajonal mamografi. Sigurisht, nëpërmjet mamografive të lëvizshme do të sigurojmë që i gjithë territori të jetë i mbuluar me këtë shërbim, të cilin edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë e konsideron si një program të vlefshëm me kosto efektive, që do të ulin riskun, sigurisht edhe invaliditetin lidhur me këtë sëmundje; do të garantojmë vijimin e programeve që kanë të bëjnë jo vetëm me parandalimin dhe kujdesin shëndetësor, por, gjithashtu, edhe me aspektet e trajtimit mjekësor; do t'u sigurojmë më shumë se 435 mijë qytetarëve me sëmundje kronike trajtime falas me alternativat e mjekimit nga skema e rimbursimit në vlerën 11 miliardë lekë; do të mbështesim më shumë se 64 mijë pacientë për ndërhyrjet operatore me instrumentet kirurgjikale nëpërmjet një procesi, i cili u siguron qytetarëve më shumë cilësi dhe personelit mjekësor, kirurgëve, kushte pune shumë më të mira; do të garantojmë kosto efikasiteti nëpërmjet një programi të suksesshëm partneriteti publik-privat, i cili do të ndikojë drejtpërdrejt në sigurinë e jetës së qytetarëve. Gjithashtu, më shumë se 10 mijë paketa të kardiologjisë, kardiokirurgjisë, katarakte, transplantimi i veshkës do të jenë të financuara në spitalet publike dhe jopublike me buxhetin shtetit për të siguruar që jo vetëm të mos kemi lista të gjata pritjeje, por t'u sigurojmë qytetarëve akses në shërbime dhe kursim të pagesave nga xhepi. Dua t'u kujtoj se pas 5 apo 6 vjetësh çështja e problemeve kardiale, infarkteve të miokardit dhe problemeve që kishin lidhje me sëmundje, që duheshin trajtuar urgjentisht, ka qenë e pamenduar të trajtoheshin në spitalet shtetërore. Sot jo vetëm që trajtohen të gjitha rastet e sëmundjeve kardiovaskulare, por, mbi të gjitha, kemi lista pritjeje, të cilat nuk janë optimale. Pra, sot për t'i bërë një qytetari një ndërhyrje invazive në zemër ai nuk duhet të presë më shumë se 2-3 javë që është një kohë optimale, duke e krahasuar edhe me sisteme të tjera që janë shumë më të zhvilluara.

Gjithashtu, për vitin 2020 do të garantojmë akses dhe cilësi, por, mbi të gjitha, do t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë rritjes së cilësisë së diagnostikimit të sëmundjeve dhe ndjekjes së tyre nëpërmjet një partneriteti të ri, i cili do të financohet dhe është buxhetuar për në 2020-ën shërbimit laboratorik në 18 spitale universitare, pra rajonale dhe dy spitale bashkiake, ku do të rritet jo vetëm numri i testeve dhe ekzaminimeve që kryejnë këto spitale, por, sigurisht, do të garantohet siguria e tyre nëpërmjet certifikimeve europiane.

Buxheti i vitit 2020 jo vetëm do të vijojë investimet e hapura në shëndetësi, por do të hapë edhe investime të reja, me fokus nënën dhe fëmijën, rritjen e aksesit në shërbimin parësor, si dhe rritjen dhe përmirësimin e infrastrukturës dhe teknologjisë spitalore, por do të

kemi edhe programe të reja që do të hapim në shëndetësi nëpërmjet këtij buxheti. Për herë të parë do të kemi mundësinë të investojmë për hapjen e shërbimit për transplantin e palcës së kuqe, duke përmbyllur ciklin e trajtimit të limfomave malinje jo vetëm me medikamente dhe terapi të targetuara, që tashmë ia kemi arritur, jo vetëm nëpërmjet listës së rimbursimit, por edhe nëpërmjet rritjes së buxhetit të spitaleve, duke garantuar që shumë pacientë, të cilëve sot u duhet të shkojnë jashtë vendit për të kryer transplantin e palcës, të kenë mundësi ta kryejnë brenda vendit tonë; do të kemi shërbim të ri të kardiokirurgjisë në spitalin universitar “Shefqet Ndroqi”, duke realizuar kështu jo vetëm uljen e shpenzimeve nga xhepi, por edhe vetë uljen e buxhetit të shtetit, i cili, për të ulur listat e pritjet në kardiokirurgji, duhet të paguante spitalet jopublike me një kosto jo aq sa paguhet në spitalin shtetëror. Ndaj, pikërisht për të maksimizuar, për të optimizuar dhe për të racionalizuar kemi vendosur të investojmë në spitalet tona dhe për të mundësuar që të gjithë pacientëve t’u ofrojmë shërbime shëndetësore të aksesueshme brenda sistemit publik. Gjithashtu, do të vijojmë me investimet e nisura.

Për sa i përket sistemit parësor, në kuadër të programit të rehabilitimit të 300 qendrave shëndetësore, për vitin 2020 do të rehabilitohen 120 qendra shëndetësore. Nga Veriu në Jug, në qytet dhe në fshat, do të kemi shërbime shumë më të mira shëndetësore për më shumë se 470 mijë qytetarë. Do të vijojnë investimet e nisura në maternitetet e Lezhës, të Beratit; do të vijojmë investimin në spitalin rajonal të Kukësit; do të hapim investimin në maternitetin “Mbretëresha Geraldinë”; do të vijojmë të punojmë për kujdesin shëndetësor të fëmijëve, duke vijuar investimin në Pediatriinë e Durrësit dhe në investimin e saponisur të spitalit pediatrik në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Do të vijojmë investimin për spitalin e ri të sëmundjeve të brendshme në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, ndërkohë që do të kemi investime edhe në pajisje të teknologjisë së lartë brenda, domethënë sipas buxhetit të vitit 2020, duke vlerësuar pikërisht nevojat e spitaleve rajonale, pasi tashmë ne kemi bërë realitet atë që kemi thënë: më shumë shërbime afër vendbanimit; më shumë shërbime të ofruara në spitalet rajonale për qytetarët shqiptarë. Do të vijojmë, gjithashtu, të investojmë në pajisje për Qendrën e Urgjencës Kombëtare dhe në poliklinikat e Gjirokastrës dhe të Peshkopisë në vijim të investimeve edhe të kredive, që tashmë janë në proces për Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale.

Për sa i përket aspektit të burimeve njerëzore, do të vijojë mbështetja me incentiva financiare për mjekët nëpërmjet bonusit prej 2,5 milionë plus pagën, dhe incentivat financiare

për ditët e punës për mjekët që ofrojnë shërbime larg vendbanimit apo spitaleve ku ata janë të punësuar.

Për sa i përket aspektit të inovacionit dhe teknologjisë, shëndetësisë elektronike, do të vijojmë të zgjerojmë shërbimet duke e shtrirë nënshkrimin elektronik për të garantuar uljen e çdo lloj abuzimi dhe rritjen e transparencës në sistemin farmaceutik, pra të linjës së farmacive të hapura për shërbimet e rimbursimit, si dhe një sistem elektronik për administrimin, për menaxhimin dhe për organizimin e punës së Fondit në raport me shërbimet farmaceutike dhe kompanitë farmaceutike sipas shtrirjes së sistemit e-depo.

Gjithashtu, do të kemi mundësinë që gjatë këtij viti sistemi elektronik ose sistemi i informacionit spitalor, i cili po ndërtohet në bashkëpunim me Bankën Botërore, të mund të përfundojë dhe të shtrihet në katër spitale rajonale, për t'u shtrirë më pas në të gjithë Shqipërinë dhe për të pasur pikërisht atë çfarë ne duam të kemi: një sistem të informacionit spitalor në kohë, i cili jo vetëm siguron transparencë, por, gjithashtu, rrit llogaridhënien qoftë nga pikëpamja e shpenzimeve që kryejnë spitalet rajonale, qoftë nga pikëpamja e miradministrimit të burimeve njerëzore dhe financiare në strukturat tona të kujdesit spitalor.

Po ashtu, do të krijojmë dy sisteme të reja, sistemin e menaxhimit të bankës së gjakut dhe sistemin e menaxhimit elektronik për vaksinimin, duke synuar një mbulim sa më të lartë vaksinal. Edhe pse Shqipëria gëzon një mbulim vaksinal të lartë, vlen që sistemi elektronik të na sigurojë kapjen në kohë të të gjitha problematikave që në terren administrohen më lehtë kur ke informacion në kohë reale.

Këto janë pak a shumë prioritetet kyçe që mbulon buxheti i vitit 2020 për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Më lejoni, besoj që në Komisionin e Ekonomisë dhe Financat ka një interes jo vetëm lidhur me prioritetet, por në raport edhe me shpenzimet dhe kostot që këto shërbime kanë, të jap edhe një informacion në raport me katër koncesionet, tre prej të cilave janë ekzistuese dhe një i ri që shtrihet në vitin 2020, që është shërbimi laboratorik në 18 spitale: buxheti i alokuar për koncesionet për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është 4 miliardë e 500 milionë lekë, të cilat janë tashmë buxhete të konsoliduara me buxhetin e vitit 2020. Do të garantojmë vijimin e programit të kontrollit mjekësor bazë sipas buxhetit të planifikuar, duke arritur mbulimin e planifikuar. Dua t'ju them që në dhjetëmujorin e parë, madje deri dje, mbulimi ose targeti i përcaktuar për kontrollin mjekësor bazë është më shumë, pra ka arritur 100%: janë 437 mijë qytetarë që kanë kryer kontrollin mjekësor bazë.

Në fakt, një prej programeve është kostoja efektive, ku edhe vetë Organizata Botërore e Shëndetësisë në një prej raporteve të vitit 2019 e ka konsideruar si një program që ka ndryshuar qasjen për kujdesin shëndetësor, për atë çfarë jo vetëm qytetarët duhet të kenë për kujdesin ndaj shëndetit të tyre, por edhe instrumentin që i ka dhënë mjekut të familjes për të pasur një instrument më shumë për të vlerësuar riskun ndaj sëmundjeve kardiovaskulare, ndaj sëmundjeve jo të transmetueshme, që, në fakt, përbëjnë 90% të barrës së sëmundshmërisë jo vetëm në Shqipëri, por në rang global.

E rëndësishme është që në momentin kur është bërë studimi i fizibilitetit, duke e krahasuar edhe në raport me studime që kanë bërë vende, të cilat kanë sisteme me qasje universale si yni, është vlerësuar si një nga programet që jo vetëm parandalon, por edhe shpëton jetë. Pra, sigurisht që është një nga programet kostoja efektive dhe kërkonte kohën e vet. Prandaj këta tre vjet e pak e kanë konsoliduar këtë program, pra ajo çfarë na ka sjellë nëpërmjet këtij programi është jo vetëm se ne kemi një bazë shumë të mirë të dhënash të të gjitha llojeve të sëmundshmërisë në vend për sa u përket sëmundjeve, por kemi edhe një përqindje të diagnostikës për sa u përket sëmundjeve që përbëjnë barrë dhe kosto më pas në trajtim, siç janë: sëmundja e diabetit, sëmundjet kardiovaskulare, anemitë, problematikat me sëmundjet tumorale, pasi këto teste diagnostikojnë në kohë edhe problematika të tilla, si: kanceri i zorrës...

Gjithashtu, vlen të përmendet pikërisht mbulimi dhe qasja e re që ka sjellë në sistemin shëndetësor dhe në rritjen e numrit të akseseve në nivelin e kujdesit parësor pikërisht ky program, gjë që i ka bërë qendrat shëndetësore të frekuentohen sot nga qytetarët, sepse nuk shkojnë aty vetëm për barnat e rimbursueshme të radhës, por edhe për të kuptuar se si ata janë me shëndet, nëse ato duhet të kujdesen më shumë apo të shkojnë të qetë, sepse edhe këtë vit analizat u kanë dalë mirë dhe vijojnë të kontrollohen çdo vit. Madje, ky është një program të cilin OBSH-ja e ka konsideruar si kosto efektive edhe për faktin se mënyra ciklike e realizimit të kontrollit mjekësor bazë siguron gjithashtu edhe uljen e invaliditetit dhe të mortalitetit për sëmundjet jo të transmetueshme.

Për sa i përket programit të partneritetit të hemodializës, vijojmë të kemi një qasje universale edhe për sa u përket të sëmurëve, të cilët vuajnë nga sëmundjet e veshkave dhe kryejnë hemodializën, më shumë se 300 pacientë të cilët e realizojnë tri herë në javë këtë proces, në fakt, këtë terapi, që është jo vetëm shumë e lodhshme, sepse duhet të bëhet tri herë në javë, por nëpërmjet këtij partneriteti ne kemi arritur që të kemi më shumë shërbime të ofruara afër

vendbanimit. Janë pesë spitale rajonale që sot, nëpërmjet këtij partneriteti, ofrojnë shërbime për më shumë se 300 pacientë, të cilët e kryejnë dializën në këto spitale.

Një tjetër partneritet, që ka ndryshuar tërësisht qasjen në shërbimin e kirurgjisë në të gjitha spitalet e vendit, gjë që ka jetësuar jo vetëm shërbimet e kirurgjisë në spitalet rajonale dhe në dy spitalet bashkiake, që kanë qenë totalisht të pamenduara për t'u realizuar, është investimi në zemër të këtij shërbimi pikërisht me instrumente të reja, me katër procese të rëndësishme jetësore që sigurojnë trajtime shumë të rëndësishme për sa u përket jo vetëm materialeve njëpërdorimëshe, pastrimit ose sterilizimit të sallave...

(Diskutime në sallë)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, komisioni, qetësi!

Ogerta Manastirliu – ...si dhe proceseve të rëndësishme që ky partneritet siguron në raport me ndërhyrjet kirurgjikale që kryhen në vendin tonë. Ky partneritet është i buxhetuar në vlerën 1 miliard e 665 milionë lekë për vitin 2020, do të sigurohemi që të jemi brenda sipas organizimit dhe miradministrimit që ne kemi realizuar për vitin 2019, si dhe do të vijojmë edhe për vitin 2020 të sigurojmë që të jemi brenda objektivave të parashikuar edhe në studimin e fizibilitetit. Por sigurojmë një gjë. Ashtu siç edhe ju, zoti kryetar, e thoni shpesh: “shëndeti nuk ka çmim; jeta nuk ka çmim”, sigurisht, ajo çfarë ne kemi bërë nëpërmjet këtyre partneriteteve, pavarësisht se në dukje janë të kushtueshme, impakti që këto partneriteti kanë në tërësi në jetën e qytetarëve është decisiv, sepse kapim elemente shumë të rëndësishme, siç janë: parandalimi me kontrollin mjekësor bazë, siguria e jetës nëpërmjet instrumenteve të sterilizuara, instrumenteve të reja dhe të gjitha proceseve që sjell ky, siç është partneriteti për dializën dhe partneriteti i ri, i cili fillon për vitin 2020, që është pikërisht partneriteti për laboratorët në 18 spitalet e vendit, ku buxheti për vitin 2020 do të jetë në vlerën 1 miliard e 200 milionë lekë. Sigurisht, nuk do të përfshihen të gjitha spitalet, pra ka një kalendar të funksionalitetit sipas kësaj kontrate: do të fillojmë me Spitalin Universitar “Nënë Tereza” për të vijuar me spitalet universitare në Tiranë deri në muajin shtator të vitit 2020, kur do të kemi shtrirjen progresive edhe në spitalet e tjera.

Kjo ishte një paraqitje sintetike e prioriteteve dhe buxhetit të vitit 2020 për ministrinë tonë.

Faleminderit për vëmendjen!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e detajuar, i cili i kapi çështjet edhe teknikisht, profesionalisht dhe politikisht!

Më vjen mirë që realisht të gjitha programet tuaja fokusohen te qytetarët, sidomos te shtresat në nevojë.

Projekti me Bankën Botërore për sa i përket ndihmës ekonomike është një projekt i qenësishëm, që ka gati tre vjet tashmë që është shpalosur dhe ka funksionuar në të dyja aspektet, qoftë në aspektin e përfshirjes realisht të atyre qytetarëve që janë në nevojë, qoftë edhe në aspektin e zgjerimit të qarqeve që preken pozitivisht në formën pilot, jo më thjesht Tirana, por, siç iu referuat ju, në mos gaboj, edhe dy qarqe të tjera. Fakti që për shkak të pikëzimit real me thelb social një pjesë e mirë e atyre që nuk kanë merituar ndihmë ekonomike janë zëvendësuar me gati dhjetëra mijëra qytetarë, të cilët kanë realisht nevojë për ndihmë ekonomike, tregon që instrumenti dhe politika juaj ka funksionuar.

Pjesa tjetër e prezantimit tuaj, që është interesante dhe e drejtë, ka të bëjë me investimet në qendrat shëndetësore. Duke ndjekur projektin që ju keni filluar që në vitin 2018 me 120 qendra shëndetësore në të gjithë Shqipërinë, mendoj që do të ishte mirë, aq më tepër që ju keni një staf shumë të mirë të administratës publike, të bënit një vlerësim të impaktit të investimit në qendrat shëndetësore, pra, sa është rritur numri i qytetarëve që frekuentojnë qendrat shëndetësore, dhe ndoshta të filloni të bëni një sondazh të cilësisë së shërbimit në qendrat shëndetësore, në mënyrë që të keni të qartë zinxhirin e shërbimit nga qendrat shëndetësore deri te spitalet, që, siç iu referuat ju në vazhdimësi, po rinovohen.

Në të njëjtën kohë, ajo që unë vlerësoj te ju personalisht si anëtare kabineti, por edhe te stafi juaj, është beteja që bëni për sa i përket transparencës së fondit të rimbursimeve. Ne kemi një histori të gjatë diskutimi për sa i përket fondit, prandaj më vjen mirë të shikoj që këtë vit qasja është jashtëzakonisht shumë e disiplinuar, shumë transparente dhe e fokusuar në ato medikamente që janë më shumë të përdorshme, me një çmim më të ulët dhe me një gamë më të gjerë, duke mbajtur shifrën 10,4 miliardë. Ndërkohë, në dijeninë time, keni shlyer edhe detyrime të prapambetura.

Shtylla e tretë, që është po kaq e rëndësishme, është “shërbimet publike”. Ju përgëzoj për miksimin e drejtë që bëtë midis asaj që afron ministria dhe institucionet apo edhe rrjeti spitalor së bashku me ato që ju iu referuat si koncesione partneritet publik-privat, të cilat në themel janë shërbime ndaj qytetarëve. Unë e kam thënë dhe do ta them në çdo lloj debati qoftë financiar, qoftë profesional, qoftë politik, që jeta nuk ka çmim.

Por nuk është ky thelbi. Thelbi është qasja, e cila është në themel të mënyrës si kjo maxhorancë dhe si kjo qeveri mendon në korsinë e shërbimeve ndaj qytetarëve në shëndetësi.

Me këtë dua të them, siç iu referuat edhe ju atij pasazhi të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (do të doja që stafi juaj ta shpërndante që ta marrin vesh shqiptarët) që *Check up*-i ka funksionuar si parandalues dhe shpëtues jete. Kemi dëgjuar vetëm tymnaja dhe lloomotitje dhe në një moment, për hir të së vërtetës, dikur ia arritën ta bënin pis atë shërbim. Sot ju thatë një gjë të vërtetë, sepse sot ka shkuar 100% mbulimi në reflektim dhe në referencë të fizibilitetit. 437 000 qytetarë shqiptarë në vit bëjnë kontroll shëndetësor falas për diabetin, sëmundje kardiovaskulare apo lloj-lloj sëmundjesh që mund të ketë një qytetar, që duhet të parandalojë apo që ndoshta edhe duhet të alertohej.

Ju me të drejtë keni sjellë (unë ia kërkoja dhe edhe ministres së Financave) dhe e kemi ndarë së bashku një fakt shumë interesant me metodologjinë e NIH (Fondi i Shërbimit Shëndetësor në Britani), pra me metodologjinë që përdor Britania dhe se çfarë do të thotë ky shërbim për qytetarët i reflektuar edhe në kosto. Pra, politikisht unë i kuptoj, por nuk i mirëkuptoj kur hedhin baltë mbi një shërbim për të cilin faktet tregojnë që ka funksionuar. Sot duhet thënë me krenari që qasja e Kryeministrit dhe qasja juaj për shërbimin shëndetësor falas ka funksionuar.

Për sa i përket diskutimit nëse ne kemi arritur të bëjmë më të mirën, sigurisht që ka shumë për të bërë. Unë jam i bindur që kur na dëgjojnë qytetarët, të cilët kanë halle të ndryshme, përsëri dikush në të drejtë të vet edhe mund të pyesë çfarë po thotë ministrja apo kryetari. Ama, po t'u referohemi viteve në aspektin e shërbimit shëndetësor, e them me krenari dhe me modesti, kjo maxhorancë nuk e ka harxhuar kohën kot. Qasja juaj për të zgjeruar shërbimin me të njëjtën kosto është gjëja më e drejtë e mundshme.

Ju iu referuat dializës, e cila është shumë e rëndësishme për ta parë nga ana sociale, nga ana shëndetësore, por edhe nga ana e kostos, sepse ju thatë me të drejtë që janë 330 qytetarë që kanë nevojë për të. Kam dëgjuar dikë në parlament të thoshte dikur kush janë këta 330 qytetarë për të cilët ju harxhoni miliona euro. Besoj e mbani mend që aty thamë të dy, edhe ju edhe unë, që jeta nuk ka çmim. Sot ju thatë të vërtetën që me të njëjtën kosto të dikurshme shërbehen disa herë më shumë një numër më i madh qytetarësh në destinacionet e tyre. Do të thotë një person nga Korça nuk vjen këtu, por i shkon shërbimi atje. Ne gjirokastritët kemi shprehjen “merohet rrugëve”.

Kur i thashë dikujt që për shkak të sterilizimit ka rënë me më shumë se 20% numri i infeksioneve postoperative, ai u tall me mua. Kjo është shpëtim jete. U tall, sepse nuk e vlerëson jetën dhe se është aty ku është. Në ditët e jetës së një njeriu, që ka një operacion dhe për

shkak të sterilizimit i shpëton infeksionit, është jetë e dytë. Me thua çmimin? Ajo që ju thatë, përveç shërbimit, por edhe uljes së kostos dhe mbajtjes në nivelet e parashikuara të momentit të parë të fizibilitetit, është po disiplinë financiare në shërbim të qytetarëve dhe në funksion të buxhetit të shtetit. Nuk diskutohet.

Nuk duhet ta harrojmë, sepse është shumë e rëndësishme për të majtën, për të djathtën, por edhe për qytetarët. Shqipëria është vendi që për një të punësuar dhe për një punëdhënës ka kontributin më të ulët në rajon, paguan më pak nga të gjitha vendet e rajonit. Më besoni dhe shikojeni. Sekretaria të marrë dokumentet e mia dhe në bashkëpunim edhe me ministrinë ta nxjerrë në *facebook*, por edhe në media. Kjo do të thotë që qytetarët dhe biznesi, krahasimisht me rajonin, paguajnë shumë më pak. E dini që vendet e rajonit paguajnë minimalisht 39%, kurse ne paguajmë 1+16+3, që është pjesa e kontributit për kujdesin shëndetësor. Pra, jemi shumë më pak, dhe mundohemi të bëjmë shumë më shumë. Këtu është thelbi i shëndetësisë falas. Kush e paguan? E paguajnë të gjithë qytetarët nëpërmjet buxhetit të shtetit në funksion të atyre komuniteteve që fatkeqësia i çon në spital. Aty nuk paguajnë ose paguajnë më pak. Dikush mund të thotë që po bëj politikë, por, më besoni, nuk po bëj politikë, po ndaj me ju thelbin human të politikës së një maxhorance, paktin social të një qeverie dhe të një maxhorance, për sa u qytetarëve në nevojë dhe shëndetit publik.

Ajo që ka thënë Kryeministri Rama, shëndetësia falas, për të cilën e ngacmuan shumë, ja ku është! Nuk ka shëndetësi falas, në aspektin e kostove që kanë shërbimet. Ka shëndetësi falas në aspektin se kush i mban në kurriz kostot, njerëzit, qytetarët, që kanë halle e i çon halli në spital apo i mban buxheti i shtetit nëpërmjet politikave balancuese, sociale e humanitare? Jam i bindur që ka shumë për të bërë. Nuk e diskutoj! Shërbimet spitalore dhe shërbimet shëndetësore kanë shumë rrugë për të bërë, për t'u... Ju iu referuat momentit të orëve në pritje, momentit të politikës suaj të re, që ka të bëjë me trajtimin ekstrem, në kuptimin jo vetëm të parandalimit, por edhe të kurimit të limfomave. Këto janë elemente të rëndësishme, që nganjëherë qytetarët nuk i kapin.

Zonja Ministre, keni nevojë të bëni shumë më shumë kontakte me publikun për punën tuaj. Kam një sugjerim miqësor. Qendrat shëndetësore janë të rëndësishme, por këto elemente që përmendët këtu janë shumë më të rëndësishme për qytetarët. Qytetarët nuk do të kënaqen, sepse në definicionin e demokracisë ata nuk duhet të kënaqen asnjëherë me ne, por do ta vlerësojnë punën dhe do të kenë më shumë informacion.

Pse duhet të prisni të vini në këtë komision, që të thoni gjithë këto gjëra që keni bërë?

Duhet ta sqaroni gjithmonë e më shumë pjesën e laboratorëve.

Çfarë janë laboratorët? Se dikush, edhe me të drejtën e vet të mungesës së informacionit, mund të thotë: “Ore, çfarë jeni duke bërë?! Ç’është ky laborator? Nuk e bënte dot shteti?!” Ta shpjegojmë. Nga 150 analiza në 160 analiza me të njëjtën kosto! Po çfarë janë këto analiza? Pse bëhen këto 160 analiza? Parandalim! E gjitha është parandalim. Kur bën analiza, parandalon, kur bën analiza më të mira ke mundësi të kurohesh më mirë, me ilaçin e duhur, në kohën e duhur, në korsinë e duhur mjekësore dhe pastaj le t’i vërë kush të dojë çmim jetës!

Zonja Ministre, ju falënderoj!

Shpresoj që komisioni të bëjë pyetje në funksion të të mësuarit më shumë për punën tuaj.

Unë mendoj se fondi juaj nuk duhet të ishte rritur 2,098 miliardë (mund të kishin thënë edhe 2,1 miliardë, se nuk është problem), por duhet të ishte më shumë.

Politika ndaj bebeve, në këndvështrimin tim, ka funksionuar. Sigurisht që kjo është një politikë afatgjatë. Pra, elementi i demografisë, që ne e kemi diskutuar disa herë bashkë me Kryeministrin, do një qasje shumë intensive. 2 miliardë janë pak.

Do t’ju ftoja të mendonit për inovacione të reja, në kuptimin e mbështetjes së rritjes demografike. Të merrni specialistët e demografisë dhe së bashku me punonjësit tuaj të shkëlqyer të hartoni projekte dhe programe, që të mbështeten nga buxheti i shtetit.

Më vjen mirë që, kur pashë investimet tuaja, jeni një nga ministritë që keni një balancë shumë të shëndetshme midis investimeve produktive dhe atyre që rëndom ndodhin në 30 vjet, investime për rikonstruksione zyrash, tryeza, kompjuterë, makina...

I fundit është investimi në ambulanca. Është i rëndësishëm. Do t’ju kërkoja juve dhe stafit tuaj, që, para se të blini edhe 100 ambulanca të tjera, do të ishte mirë të bënit një studim logjistik. Është shumë e rëndësishme, që të mos i çojmë dëm paratë, të bëni një studim logjistik se sa është pritja akoma, se cilat janë distancat e pambuluara, se cilat janë distancat më të gjata dhe terrenet më të vështira, në mënyrë që, nëse ju duhen, patjetër, t’i merrni. Nëse ju duhen ambulanca qyteti, merrni ambulanca qyteti, nëse duhen ambulanca për zona malore, merrni ambulanca për zona malore. Nëse duhen helikopterë, sepse keni statistika të ngarkuara të aksidenteve rrugore, që kanë nevojë për ndërhyrje e të tjera, mund edhe të planifikoni ambulanca helikopterë.

Pra, do t'juja kërkoj këtë në mënyrë që jo thjesht të rrisim numrin e ambulancave, por të kemi një koncept dispeçerie dhe një logjistikë shumë të saktë të lidhur me profilin e nevojave të urgjencës.

Faleminderit!

Nëse ka pyetje, ju lutem...!

Po, zoti Roshi.

Suzana, ju lutem! Më falni!

Suzana Topi – Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre!

Në vitin 2018 ju keni qenë në spitalin e Përrenjasit dhe keni premtuar rikonstruksionin e spitalit të Përrenjasit, që ende nuk është bërë. Realisht, gjendja e spitalit është tejet e amortizuar. Ka mungesa të theksuara pajisjesh mjekësore, shtretër dhe gjithçka tjetër që i nevojitet spitalit. Po ashtu, aty janë dy autoambulanca, ku njëra është, le të themi, më së shumti e prishur sesa në gjendje pune dhe tjetra diçka më ndryshe. Për vetë pozicionin që ka spitali i Përrenjasit, duke qenë se është në një vend ku kalon rruga nacionale, nuk u shërben vetëm banorëve të zonës, por të gjithë shqiptarëve.

Dua të di, në këto 120 qendra që ju përmendni për t'i rikonstruktuar, a është përfshirë spitali i Përrenjasit? A është përfshirë ndonjë ambulancë për të ardhur aty?

Kam edhe një pyetje tjetër. Ju thoni se keni shtuar gamën e medikamenteve, që trajtohen me recetë rimbursimi. Ju rimbursoni falas alternativat më të lira të barnave. Një i sëmurë me hipertension rimbursohet rreth 300 lekë në muaj. Nga studimet e fundit të OBSH-së, në vendet me të ardhura më të ulëta, si Shqipëria dhe vende të tjera, rreth 10% e barnave qarkullojnë të falsifikuara. Besoj se edhe Shqipëria nuk mund të jetë jashtë këtij parashikimi.

Pyetja ime është: a ka kapur Qendra e Kontrollit të Barnave barna të falsifikuara këtu te ne?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha të jeni sa më koncize, që të kemi kohë edhe për Ministrinë e Arsimit më pas!

Ogerta Manastirliu – Për të kthyer një përgjigje shteruese, jo vetëm për spitalin e Përrenjasit, por edhe për spitale të tjera, ashtu si dhe shumë qytetarë apo të interesuar mund të pyesin, ne jemi duke investuar jo vetëm mbi bazën prioritare, por edhe aty ka edhe impakt më të madh dhe ku shërbimi që ofrohet është i kompletuar. Jo se Përrenjasi apo spitale të tjera

bashkiake nuk kanë nevojë t'i fusim në rehabilitime apo në ndërtime të reja, por sepse ne, para se të investojmë, jemi duke punuar për një plan racionalizimi për spitalet bashkiake. Çfarë do të thotë kjo? Ju e dini që jo vetëm lëvizjet demografike, por edhe epidemiologjia ka ndryshuar, edhe vetë lëvizjet e birimeve njerëzore të profesionistëve të shëndetit sot nuk garantojnë t'i kemi të gjitha specialitetet në të gjitha spitalet bashkiake. Ndaj, ne, së bashku me Bankën Botërore dhe kompaninë, kemi lidhur tashmë një kontratë për të hartuar një plan të racionalizimit për spitalet bashkiake, e cila do të na japë edhe një panoramë të asaj që duhet të ndërtojmë apo të rehabilitojmë në bashki të ndryshme të vendit, ku sot me të vërtetë qendrat spitalore janë amortizuar dhe jam shumë dakord me ju. Unë kam vajtur dhe shkoj vetë për të prekur terrenin, për të kuptuar se si e kemi situatën. Përfshirja nuk mund të jetë te qendrat shëndetësore, sepse qendrat shëndetësore i përkasin nivelit të kujdesit parësor. Spitalet janë spitale. Spitali i Përrenjasit është një spital bashkiak dhe brenda 6 muajve presim të kemi planin e racionalizimit. Jemi duke punuar me *price water coopers* për të bërë një plan të mirëfilltë të asaj që na nevojitet në bashki të ndryshme, si strukturë spitalore, për t'i kthyer këto spitale në qendra të trajtimit ditor dhe të emergjencës. Pra, të mos shpenzojmë... Ne nuk jemi të pasur për të shpenzuar në rehabilitime dhe për të lënë godina bosh, që më pas kthehen në kafaze pëllumbash, por për të bërë investime të mençura dhe për t'u vonuar pak, por në momentin që i bëjmë këto investime të jenë të qëndrueshme dhe të ofrojnë shërbime për qytetarët. Nuk është e thënë, pasi spitali i Brinjasit në metra katrorë është shumë i madh dhe sikur ta rindërtonim sot nuk do të kishim me çfarë ta mbushnim. E para se popullata e Përrenjasit është ulur në kuadër të lëvizjeve demografike.

E dyta, sepse ai spital sot nuk ka nevojë për pavijone, por ka nevojë për një shërbim urgjence, një shërbim laborator, një imazheri të nivelit bazë dhe për një shërbim patologjie të shpejtë. Përrenjasi ka një specifikë, sepse duke qenë se lidhen shumë rrugë, ka dhe shumë aksidente.

Ju keni të drejtë dhe ne shumë shpejt do të sjellim një autoambulancë, jo nga ato të rejat, sepse janë shpërndarë në spitalet rajonale, për të fuqizuar flotën e autoambulancave dhe për të pasur më shumë akses drejt spitalit të Elbasanit që sot është një ndër korpuset spitalore më të mira për sa i përket standardit, cilësisë që ofron.

Për sa u përket medikamenteve, listës së rimbursimit, më lejoni që të them se në konsultim me Organizatën Botërore të Shëndetësisë në këto momente jemi duke hartuar strategjinë për listën e ardhshme të rimbursimit, metodologjinë. Prej 2 vjetësh lista apo skema e

rimbursimit jo vetëm që është një skemë më vizibël, ka më shumë optimizim dhe racionalitet brenda buxhetit. Për vitin 2019 vitin aktual do të jemi në pritshmëritë e buxheteve të përcaktuara duke shlyer edhe detyrimet, duke kryer 2 ndërhyrje shumë të rëndësishme për disiplinimin e fondeve. I pari është indeksimi i çmimeve.

E dyta, ne kemi garantuar që me ato kompani multinationale, të cilat sot tregtojnë barna të sigurta në Shqipëri, të kemi çmime preferenciale për barna të targetuara për terapi të shtrenjta dhe jo më për terapi, të cilat mbulojnë hipertensionin, diabetin e të tjera. Shqipëria është një ndër vendet që në listën e barnave të rimbursueshme ka një përfshirje të shumëllojshme të këtyre barnave.

Alternativa e parë është e rimbursueshme 100%. A e dini se sa është e rimbursueshme dhe se sa përfitojnë alternativë të parë dhe sesa paguajnë? Zero pagesa, bëjnë 98% të përfituesve. 98% e 370 mijë qytetarëve që përfitojnë nga skema e rimbursimit e marrin alternativën falas. Sipas politikës së qeverisë shqiptare që tha se: 600 mijë të pasiguruar do të trajtohen falas, kategoritë që janë vulnerabël do të trajtohen falas, pra 98% e përfituesve në skemën e rimbursimit janë falas, vetëm 2% janë ata të cilët kanë dëshirë të trajtohen jo me alternativën e parë, apo janë kategori që duan të përdorin bashkëpagesën që ekziston jo vetëm te ne, por ekziston si skemë në të gjitha vendet e botës.

Për sa u përket sëmundjeve si hipertensioni, dua të them se ne kemi paketën më të plotë për hipertensionin. Alternativa e parë nuk duhet të ketë asnjë abuzim. Ne jemi të parët që duhet të informojmë publikun. Ka të drejtë zoti Ahmetaj, që ne duhet të garantojmë jo me fjalë, por me ato që garantojmë nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore që çdo bar që vjen, importohet në Republikën e Shqipërisë dhe çdo bar që prodhohet apo tregtohet në Republikën e Shqipërisë është një bar i sigurt. Nuk duhet të biem viktimë të dezinformimit, nuk ka barna që janë në skemën e rimbursimit që mund të jenë false, sepse ka një regjistër të plotë të regjistrimit dhe të kontrollit të barnave për efektshmërinë. A e dini se në Agjencinë Kombëtare të Barnave nuk ka asnjë reklamim për mosefekt të barnave? Kur nuk ka një reklamim, pse duhet të themi që ka barna të tilla...

Arben Ahmetaj - Zonja Ministre, këtë gjë thuaje me qetësi, sepse është e mirë.

Ogerta Manastirliu – Shumë ndërhyrje e drejtë, duhet ta them më qetësisht.

Arben Ahmetaj - Do t'ju lutem, se ju pak e keni përgjigjen, por pak më shkurt.

Ogerta Manastirliu - Për ta mbyllur Agjencia e Barnave operon me të gjitha strukturat e shtetit, me Policinë e Shtetit, me prokurorinë që në raste të konstatimit të barnave

qoftë me çmime false, qoftë të barnave që kanë reklamime nga Policia e Shtetit apo nga strukturat e tjera të jetë e para që realizon këtë detyrë për t'u siguruar qytetarëve cilësi, siguri për barnat që tregtohen, importohen apo prodhohen në vendin tonë.

Arben Ahmetaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Roshi, ti e ke pyetjen gjithmonë të shkurtër dhe koncize. Edhe përgjigjen siç tha zonja Gjylameti e ke shumë më koncize sesa ministrja.

Artur Roshi - Këtë e di.

Zonja Ministre, ju dëgjova më vëmendje, në fillim fare do të them disa gjëra pozitive, se çfarë kemi vënë re. Ajo që mund të themi si pozitive në sektorin e mjekësisë është bërja e recetave elektronike dhe mosmarrja më në farmaci e ilaçeve të shitura prej farmacistëve dhe jo me receta. Kjo është një gjë që duhet ta vlerësojmë.

Për sa i përket problemit të koncesionit unë kam rezerva, por ndoshta kjo nuk i përket përgjegjësisë suaj, sepse është bërë në një kohë tjetër, ju jeni në vazhdimësi, ndoshta ka vende të tjera ku mund ta diskutojmë dhe ta trajtojmë politikisht dhe teknikisht pyetja konkrete imja lidhet me procedurat e përfitimeve të rimbursimit të moshat e treta. A nuk ju duket e ngarkuar që ato shkojnë i drejtohen mjekut të familjes një herë në 3 muaj apo një herë në 6 muaj? Njerëzit që janë të sëmurë kronikë, nuk do të thotë që ne të presim përmirësim, i rraskapitim duke i endur dyerve të mjekëve për një gjë që është e pranueshme. Sëmundja mund të përkeqësohet, por nuk mund të ndalohej dhe këtë e dimë të gjithë.

A keni ndonjë merak në krahasim me atë çfarë keni kërkuar për të buxhetuar si ministri, në kontekstin e skemës së rimbursimeve? Pra, nëse numri është X, ju keni kërkuar X+N, N-ja e shtuar, përveç numrit X që sot rimbursohet, a është miratuar në masën që ju e kërkon, apo jo? Sipas mendimit tim, gjendja ekonomike e rënduar e vendit sjellë edhe ulje të imunitetit të çdo qenieje njerëzore, sepse, kur kemi gjendje ekonomike të keqe, bie edhe imuniteti dhe rritet gama e njerëzve të sëmurë. Kështu që në këtë kontekst, a shkoni ju me këtë përqasje dhe a jeni e kënaqur me këtë kufi buxheti, që është buxhetuar nga Ministria e Financave?

Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj- Zonja Ministre, ju lutem, jini kaq koncize sa zoti Roshi!

Ogerta Manastirliu Pika e parë ka lidhje me një shqetësim të drejtë dhe ne kemi dy vjet që po punojmë, me të gjitha procedurat e deregulimit apo të lehtësimit të procedurave, sa u përket sorollatjeve që në sistem nuk kanë qenë të pakta, edhe për kategoritë e moshës së tretë,

për të marrë barnat e rimbursueshme, kryesisht për të sëmurët kronikë. Ajo që ne kemi realizuar është jo vetëm që receta elektronike, që ju e thatë, e ka shmangur kohën e pritjes për të marrë barnat e rimbursueshme, por që nga muaji shtator kemi përfshirë recetën 6-mujore. Pra, në momentin që një i moshuar është kronik dhe diagnoza është e vendosur nga mjeku, ai nuk ka nevojë të shkojë çdo dy muaj te mjeku për të marrë recetën, por e merr një herë në 6 muaj me tri rimbushje dhe paraqitet në farmaci për të marrë medikamentin. Kjo është bërë në muajin shtator dhe kërkohet kohë deri në një qasje universale, pra që të gjithë mjekët të çojnë të gjithë pacientët, edhe në aspektin e sigurisë së jetës, sepse ata kërkojnë që t'i shohin të moshuarit për të vlerësuar statusin e tyre shëndetësor, por ajo që kemi bërë është që e kemi dereguluar, kemi bërë recetën 6-mujore, në mënyrë që të mos shkojnë aq shpesh te mjeku dhe të mos kenë sorollatjet.

Për sa i përket pikës së dytë...

Artur Roshi – Kam një sqarim të vogël. Jam dakord në qoftë se edhe analizat janë futur në kornizë.

Ogerta Manastirliu- Po, janë receta 6-mujore. Ndërsa për sa u përket analizave, pikërisht partneriteti që ne do të krijojmë vitin që vjen për laboratorët do të lehtësojë edhe procedurat që sot kanë lidhje me analizat, sepse analizat që kryheshin në një spital X duhet të vinin në Tiranë për t'i bërë dhe ishte një lloj angazhimi, ndërkohë që nga viti që vjen do të shmangen edhe ato problematika që lidheshin me referencën në spitale qendrore nga realizimi i këtij partneriteti të laboratorëve.

Për sa i përket pyetjes nëse jemi të kënaqur me buxhetin, nuk besoj se askush në asnjë sektor dhe në asnjë vend të botës të jetë i kënaqur me buxhetet, por e rëndësishme është që ne të vijojmë konsolidimin e programeve që ne kemi, ku brenda buxhetit të ndërmarrim programe dhe politika të reja në funksion të rritjes së aksesit dhe cilësisë. Besoj se një ndër prioritetet kyçe që Shqipëria ka është që të jetë racionale, realiste dhe sa më e stabilizuar në hapat që hedh, sidomos për shërbime të cilat, kur flasim për shëndetësinë, duhet të jenë shërbime të qëndrueshme. Ndaj, unë besoj se ky buxhet plotëson nevojat, politikat dhe programet që Ministria e Shëndetësisë ka ndërmarr prej vitesh, hap politika, programe të reja, shërbime të reja për qytetarët dhe konsolidon ato që ne kemi ndërmarrë. Në vitet në vazhdim...

Arben Ahmetaj- Faleminderit, Ministre!

Një alert që më vjen nga anëtarët e komisionit, por edhe nga komuniteti i farmacive është që përtej monitorimit dhe kontrollit që ju u bëni, ka një komandim të pashkruar të fshehur midis doktorëve dhe farmacive nëpërmjet recetës. Ky problem ka shumë vite, por tani që po

kalojmë te receta elektronike dua t'ju sugjeroj të mendoni një sistem inovativ tjetër, ku recetat nga doktorët të bëhen elektronikisht, të menaxhohen nga një platformë e pavarur elektronike dhe të shpërndahen në mënyrë racionale në të gjitha farmacitë. Pra, unë jam doktori që i bëj recetën X farmacie, prandaj farmacitë ankohen që bëjnë marrëveshje me doktorët. Unë them, përderisa kemi kaluar në recetën elektronike, të bëni një projekt që të gjitha recetat të menaxhohen nga një sistem shumë i thjeshtë qendror dhe me një algoritëm të balancuar të dërgojnë recetat në farmaci të ndryshme online, sepse sistemi...

Artur Roshi- I bie që nga Kombinati të shkojë në Kinostudio ta marrë, ndërkohë që qytetari e do në Kombinat.

Arben Ahmetaj – Unë fola për algoritëm, që do të thotë afërsia me shtëpinë apo spitalin, lloji i ilaçit nëse ka ose jo në një farmaci, balanca financiare e të tjerë. Algoritmi do të krijojë barazi trajtimi, por do të shkëpusë lidhjen midis mjekut, lidhjen korruptive, dhe farmacisë, sepse kemi ankesa nga farmacitë që thonë se më vë kusht doktori që ta dërgoj te ju dhe t'i të më japësh...Ky është fakt.

Po, zoti Elezi.

Arben Elezi - Përshëndetje, zonja Ministre!

Ju dëgjova me vëmendje dhe kam një shqetësim për farmacitë. Unë gjykoj se duhet bërë një hetim nga ana juaj, pasi kam informacion se shumica e farmacive, mbi 30% e tyre, komandohen ose janë pronarë doktorët që janë të punësuar në spitalet shtetërore. Ju lutem, bëni një vëzhgim ose hetim dhe na ktheni një përgjigje! Ju faleminderit!

Arben Ahmetaj- Zonja Kushi, do të filloni ju dhe pastaj të gjithë me radhë deri te zoti Vullnet Sinaj.

Evis Kushi- Zonja Ministre, shumë faleminderit për prezantimin tuaj të plotë dhe të detajuar, i cili na sqaroi shumë gjëra që lidhen me buxhetin e vitit 2020 për sektorin e shëndetësisë dhe të mbrojtjes sociale!

Unë kam një pyetje që lidhet me personelin shëndetësor. Gjatë viteve të fundit ka pasur në mënyrë të vazhdueshme mbështetje për këta punonjës, qoftë sa i përket rritjes së pagave, kushteve të punës, mjeteve, instrumenteve e të tjerë dhe është një nga sektorët që unë dua t'ju komplimentoj, sepse ka një diferencë të jashtëzakonshme në cilësinë e shërbimit, uljes së nivelit të korrupsionit e kështu me radhë, por unë dua të nisem nga një shqetësim, që edhe opozita i mëshon shumë kohët e fundit, lidhur me një dëshirë që kanë të diplomuarit apo personeli ekzistues, infermierë apo mjekë, për të shkuar jashtë shtetit, nisur kjo edhe nga kërkesat që kanë

shtete e tjera për ta stimuluar këtë gjë. A keni ju politika afatmesme apo afatgjata, apo një strategji se si ta motivioni personelin shëndetësor, kryesisht infermierët, për të lëvizur nga vendi? Kuptohet që këto nuk janë politika sot për ne, por janë politika afatmesme dhe afatgjata.

Faleminderit!

Ogerta Manastirliu- Në politikat afatmesme dhe afatgjata sigurisht një ndër komponentët që ndikon në uljen e mobilitetit të mjekëve, po e them kështu, sepse nuk është një fenomen që prek vetëm Shqipërinë, por ka prekur të gjitha vendet jo vetëm përreth nesh, por edhe europiane, pika e parë është rritja e pagave. Në politikat afatmesme dhe afatgjata ne patjetër që do të mbështetim personelin mjekësor me rritjen e pagave, ashtu siç kemi bërë në vitet 2017-2019, ku pagat janë rritur mbi 20% për personelin, mjekë dhe infermierë, dhe, ndërkohë do të vijojmë me incentivat financiarë, ku, siç e thashë, buxheti i vitit 2020 do të ketë bonusin, që nuk është i pakët, por është 2,5 milionë lekë plus pagën, për një mjek, i cili pranon të shkojë në një spital rajonal për të punuar, si dhe incentivat financiare mbi bazën ditore, por si politika afatgjate, e para, është rritja e pagave për mjekët dhe infermierët dhe e dyta, krijimi i kushteve më të mira të punës, i cili qëndron edhe në bazë për të kryer ata një punë më të mirë.

Blerina Gjylameti- Faleminderit, zonja Ministre, për të gjithë ekspozenë dhe punën e bërë gjatë vitit të shkuar, po ashtu edhe planifikimit për vitin që vjen!

Pyetja ime është e përsëritur, e cila ka të bëjë në lidhje me studimin dhe planifikimin për t'u përshtatur me ndryshimet demografike që ka në Shqipëri. Ajo që vëmë re është se kemi zona të shpopulluara, zona të mbipopulluara dhe lagje të reja, të cilat nëse i shohim në numër banorësh, krahasohen me qarqe në Shqipëri dhe jo me lagje, ndërkohë që numri i personelit, po ashtu edhe ambientet janë ato që kanë qenë, ose me ndryshime të vogla që keni bërë ndër vite, me pikat ambulatorë që janë hapur, por përsëri të pamjaftueshme për t'u shërbyer qytetarëve që janë aty. Çfarë studimi është bërë, nëse është bërë një i tillë, dhe ndryshimet që ju bëni, qoftë në personel, qoftë në investime, a janë në përputhje me studimin që keni bërë apo jemi ende te faza ku mundohemi të gjejmë zgjidhje afatshkurtër pa parë atë që duhet të jetë afatgjatë? Këtë pyetje e bëj për zona të Tiranës, por jo vetëm, që tashmë për nga numri i popullsisë, edhe pse është defekt, këtu duhet theksuar, i qytetarëve, të cilët nuk regjistrohen në gjendjen civile përkatëse, por ende e mbajnë atë nga qytetet apo lagjet që vijnë, por përsëri unë besoj që nëpërmjet projektit që është bërë nëpërmjet Ministrisë së Brendshme dhe OSHEE-së të kemi një studim që t'u përshtatet nevojave të zonave. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zonja Ministre!

Ogerta Manastirliu – I kemi paraprirë këtij shqetësimi, jemi gati për të prezantuar strategjinë e kujdesit parësor, e cila në thelb të saj ka të gjithë riorganizimin e kujdesit parësor dhe, sigurisht, prek direkt qendrat shëndetësore dhe ambulancat në të gjithë vendin. Pra, kur flas për vendet, flas edhe për zona rurale, zonat urbane, lëvizjet demografike, epidemiologjinë, pra të gjitha ato kritere që sot janë të ndryshuara për kontekstin e vendit tonë dhe ajo çfarë jemi duke bërë është kostifikimi i kësaj strategjie. Sigurisht, kjo strategji nuk është 1-vjeçare, por është një strategji 5-vjeçare, e cila jo vetëm kërkon burime shtesë njerëzore në aspektin e mbulimit shëndetësor universal, që ne kemi e qëllim madhor të programit tonë qeverisës, por edhe në aspektin ndryshimeve infrastrukturore që kërkojnë burimet njerëzore. Sigurisht, ndryshimet e reja demografike që kemi, pra strategjia e kujdesit parësor është në fazën e kostifikimit dhe besoj se nga viti 2021 fillon implementimi i saj.

Kurse për i përket shqetësimit tuaj në lidhje me Tiranën, ne jemi duke marrë masa që në vitin 2020 të buxhetojmë dy ambulanca te Kodra e Diellit dhe në zonën e Astirit për të ulur flukset, që aktualisht kanë qendrat shëndetësore dhe për të krijuar një lehtësi më të madhe. Pjesën e personelit shëndetësor e mbulojmë me distribucionin që po bëjmë brenda strukturave.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin e bërë nga ana juaj në mënyrë të detajuar për buxhetin e vitit 2020, dhe, njëkohësisht, edhe një falënderim të veçantë për ju si drejtuese e kësaj ministrie dhe stafit për të gjitha arritjet që keni bërë gjatë vitit 2019 në drejtim të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve! Unë kam dy pyetje: një nga sektorët që ju si ministri mbuloni është edhe mbrojtja sociale dhe prioriteti i punës suaj është zbatimi i skemës së re të vlerësimit dhe programeve të integritimit social, i cili do të sjellë reduktimin e numrit të familjeve dhe individëve në nevojë, të cilët përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, duke arritur, nga 66,5 mijë familje aktualisht, në 65 mijë familje në vitin 2022. Pyetja ime është: cilët janë mekanizmat që ju do të përdorni për të arritur këta tregues?

Fondi socialë është krijuar nga ana juaj për të mbështetur njësitë e vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të ndihmës ekonomike me paketa sociale dhe shëndetësore. A mendoni se fondet e akorduara nga ana juaj do të mbulojnë nevojat apo kërkesat që këto bashki kanë për këto kategori?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Zonja Ministre, të dyja pyetjet në një përgjigje të vetme që të fitojmë kohë.

Faleminderit!

Ogerta Manastirliu – Në fakt, të dyja pyetjet kombinohen.

Skema e ndihmës ekonomike është një skemë, e cila nuk mund të jetë më një skemë e përhershme e ndihmës ekonomike për familjet, por është një skemë, e cila i jepet familjes në momentet më të vështira të saj. Tashmë jemi në momentet e një strategjie dalje nga skema e ndihmës ekonomike, që brenda këtij viti miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave. *Exit* strategjia që po përgatisim do të japë të gjitha elementet se si një familje mbështetet nëpërmjet programeve të punësimit, të formimit profesional për daljen nga skema e ndihmës ekonomike dhe vajtjes drejt punësimit të qëndrueshëm. Pra, instrumenti që do të përdorim është strategjia e daljes, e cila është një mekanizëm, që përmbledh të gjitha institucionet, bizneset dhe pushtetin lokal, në funksion të mbështetjes së familjeve apo individëve në nevojë.

Për sa i përket fondit social, dua të përgjigjem me një fjali. Nuk mund të mbajë qeveria ngritjen e gjitha shërbimeve sociale. Qeveria stimulon ngritjen e shërbimeve sociale, por bashkitë duhet të marrin përgjegjësitë që ato kanë për komunitetet në nevojë. Instrumenti i fondit social është një instrument bashkëfinancues, nuk është një instrument që financon pafund shërbimet sociale në bashki. Bashkitë, kur bëjnë buxhetet e tyre dhe vendosin që të ndërtojnë rrugë dhe ujësjellës-kanalizime, le të llogarisin fonde edhe për ndërtimin e shërbimeve sociale edhe për kategoritë në nevojë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Faleminderit, zonja Dhima për pyetjet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një porosi nga komisioni për një qendër sociale shumë shembull, që është Qendra Horizont në Fier, që ta planifikoni për financim, në mënyrë që ata 90 fëmijë, në mos gabohem, të mos ngelen në rrugë. Është një kërkesë e drejtpërdrejtë e zonjës Dhima, ka gati 6 muaj, që lobon me shumë humanizëm dhe dashuri për atë qendër. Ne të dy e kemi parë atë qendër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka 6 muaj që zonja Dhima dhe më pas zoti Xhavit kanë kërkuar për këtë qendër. Madje, unë dhe zonja Dhima e vizituam vetë, pashë ata 90 fëmijë që kanë nevojë për mbështetje. Kështu që, zonja Ministre, një ndryshim të programeve dhe zërave tuaj në funksion të financimit të kësaj qendre, besoj se do ta bëjmë së bashku.

Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Sinaj!

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë nuk kam parë ndonjë ministre tjetër të ketë ardhur në komision dhe të jetë pritur kaq mirë nga opozita dhe me kaq falënderime nga pozita. Dua të sjell edhe falënderimet e qindra banorëve të qarkut të Vlorës, të cilët përfituan nga ligji për asistencën sociale që ju nxorët, që bën pjesë tek ai grupi 4500 deri 5000 qytetarë shqiptarë, të cilët ishin vendosur mes dy ligjeve të shëndetësisë dhe ligjit të sigurimeve shoqërore dhe nuk përfitonin. Ligji që ju nxorët, që e sollët në parlament, u dha mundësinë këtyre 4500 qytetarëve që të përfitojnë. Faleminderit, në emrin e qindrave qytetarëve të qarkut të Vlorës!

Njëkohësisht, fjalën tuaj e dëgjova me vëmendje dhe gjeta shumë probleme të zgjidhura edhe për zonën time.

Njëkohësisht, ju sjell falënderimet edhe nga qytetarja Esmeralda Çelaj, për transplantin e veshkës që ministria juaj e realizoi falas në Spitalin Amerikan. Kjo flet për një punë shumë të mirë dhe ju i meritoni më të vërtetë, që t'ua themi këto gjëra.

Tani, dua të kaloj edhe te kërkesat, sepse jo çdo gjë shkon në mënyrë perfekte, ka edhe probleme. Kohët e fundit kam pasur disa kërkesa nga qytetarët për punën e protezave dhe dua të di pak situatën në të cilën ndodhet problemi i këtyre protezave për t'u ardhur në ndihmë këtyre qytetarëve që kanë nevojë për to. Dua të vazhdoj ende kërkesën time për zonat tepër malore dhe rurale që e kanë shumë të vështirë pasjen e farmacive në ato zona. Ju do të thoni shërbimi i farmacive është privat, por është shumë e vështirë të gjesht një privat në zonat malore që të hapë një farmaci. Shikoni mundësinë e krijimit të ndonjë mundësie në ligj për të ndërtuar një shërbim shtetëror në këto zona të veçanta.

Pashë që keni rreth 100 ambulanca për të dhënë në vitet 2020-2021, shpresojmë që t'i vijë radha edhe Bashkisë Selenicë për ndonjë ambulancë. Faleminderit, zoti kryetar!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Urdhëroni, zonja Ministre, por shkurt, sepse është pyetja e fundit!

Ogerta Manastirliu – Për sa i përket shqetësimit në lidhje me Shërbimin e Ortopedisë, në fakt për protezat ortopedike, dua t'ju them se tashmë ka një kontratë të lidhur në Spitalin e Traumës, në Shërbimin e Ortopedisë për sa i përket mbulimit 100% për urgjencat në Shërbimin e Ortopedisë. Kurse për sa i përket planifikimit, ka një listë pritje. Të them të vërtetën, ende nuk e kemi zgjidhur që të ulim listën e pritjes për ortopedinë. Pra, në kuptim e asaj që kemi arritur me

reduktim 50% në listat e tjera të pritjes për shërbime të tjera. por jam e bindur që në buxhetet e tjera më shumë fokus do t'i kushtojmë dhe këtij shërbimi. Për agjencinë farmaceutike patjetër që do të kemi mundësi që të punojmë me farmacitë, ndoshta të qyteteve, që t'i "detyrojmë" për të hapur agjenci farmaceutike në strukturë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Ministre, ishit shumë e qartë!

Ju falënderoj të gjithëve, për pyetjet dhe qëndrimet! Faleminderit, zonja Ministre, nuk duam t'ju marrim më shumë kohë nga puna juaj! Punë të mbarë!

Pesë minuta pushim që të vazhdojmë me Ministrinë e Arsimit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

2. Seancë dëgjimore për shqyrtimin e investimeve të parashikuara dhe buxhetin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë në projektbuxhetin e vitit 2020.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Arben Elezi, Ervin Bushati, Blerina Gjylameti, Evis Kushi, Xhavit Bushaj, Antoneta Dhima, Roland Xhelilaj, Senida Mesi, Vullnet Sinaj, Eljo Hysko, Edlira Hyseni, Suzana Topi, Reme Lala, Artur Roshi, Krenar Ryçi, Korab Lita, Sadi Vorpsi

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Ylli Shehu.

Të ftuar:

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

1. znj. Besa Shahini Minister
2. Oltjon Muzaka, Sekretar I Përgjithshëm
3. znj. Mirela Bimo, Drejtore e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar
4. z. Eridon Kotrri, Këshilltar

Blerina Gjylameti - ...mbi të gjitha planifikimi.

Zonja Shahini, fjala për ju.

Besa Shahini - Ju falënderoj për mundësinë për ta prezantuar edhe një herë projektbuxhetin për arsimin për vitin 2020. Dua të bëj një njoftim, që ju besoj se e dini, për të gjithë ato që po na shohin përmes ekraneve televizive. Buxheti i sektorit të arsimit nuk përkon me buxhetin e Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, për shkak se sektori i arsimit mbulohet edhe nga institucionet e tjera, ndërsa Ministria e Arsimit mbulon edhe fushat që nuk merren me arsim. Ky diferencim bëhet për shkak se në vijim do të flas vetëm për buxhetin e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, por në fillim dua të flas për të dyja buxhetet.

Sektori i arsimit në përgjithësi mbulon parashkollorin dhe mirëmbajtjen e shkollave që mbulohen nga bashkitë, pra nga pushteti vendor, si dhe përfshin arsimin profesional, që mbulohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Buxheti total i parashikuar për vitin 2020 për të gjithë sektorin e arsimit është rreth 59 miliardë lekë. Për krahasim, në vitin 2019 ka qenë 56 miliardë lekë dhe për vitin 2018 ka qenë 53 miliardë lekë për të gjithë sektorin. Nga ky buxhet rreth 10 milionë lekë kanë qenë për bashkitë, që kanë mbuluar parashkollorin dhe mirëmbajtjen infrastrukturore të shkollave dhe 3,3 miliardë lekë kanë mbuluar arsimin profesional, buxhet i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë mbulon të gjithë sektorin e arsimit parauniversitar, arsimin e lartë, kërkimin shkencor universitar, sepse ka kërkim shkencor që bëhet edhe nga institucionet e tjera, si dhe fushën e sportit dhe rinisë.

Buxheti i parashikuar për vitin 2020 për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë është 42,5 miliardë lekë dhe, duke e krahasuar me vitin 2019, pas shtesave që ju bënë buxhetit për arsimin në kuadër të Paktit për Universitetin, buxheti ka qenë 41,2 miliardë lekë dhe në vitin 2018 buxheti për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë ka qenë 38,5 miliardë lekë. Nga këto 30,9, apo 31, miliardë lekë janë për arsimin parauniversitar, 10 milionë lekë janë për arsimin e lartë, se 13, nëse i marrim parasysh edhe të ardhurat që i grumbullojnë vetë universitetet publike. Rreth 650 milionë janë të dedikuara për shkencën, duke e përfshirë këtu edhe infrastrukturën e kërkimit shkencor, si dhe 490 milionë lekë janë për rininë dhe sportin.

Rritja e vazhdueshme e buxhetit për sektorin e arsimit, si dhe për Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë nënvizon faktin se arsimi ka qenë dhe mbetet prioriteti numër 1 për qeverinë e Republikës së Shqipërisë.

Dua të ndalem pak te Pakti për Universitetin, sepse e ka rifokusuar vëmendjen e të gjithë qeverisë gjatë vitit 2019, tek arsimi i lartë. Kemi pasur edhe një rritje të buxhetit, që i është shtuar buxhetit të vitit 2019 me akte normative gjatë vitit 2019 dhe unë besoj se ia vlen që të fokusohemi te kjo pjesë dhe të flasim për arritjet dhe sfidat që na presin në vitet në vijim. Pakti për Universitetin ka kapur në total një shifër prej 2,3 miliardë lekësh, prej të cilave një pjesë kanë qenë buxhet i ministrisë, i cili është rialokuar dhe është një shtese prej 1,7 miliardë lekësh të reja. Pakti për Universitetin, që erdhi si një rezultat i një proteste studentore në muajin dhjetor të vitit 2018, e cila vuri në pah problematikat e ndryshme tek arsimi i lartë, mori një përgjigje me një sërë masash, duke përfshirë edhe masa financiare që afektojnë direkt studentët, pra buxhetin familjar që përdoret për të arsimuar të rinjtë tanë. Kjo politikë përfshin bursa për studentët ekselentë, për të cilët e kemi zgjeruar fashën, nuk janë studentë ekselentë vetëm ata që kanë notën mesatare 10, por të gjithë studentët që kanë nota mesatare nga 9-10, dhe studentë të ndryshëm, që u përkasin kategorive të ndryshme në nevojë, siç janë studentët me aftësi të kufizuara, ata që u përkasin familjeve që marrin asistencë sociale e të tjerë. Këto dy grupe kanë fituar bursa, pra ata që janë ekselentë dhe duam t'i stimulojmë që të vijnë të studiojnë dhe të marrin nota të mira, si dhe ata që kanë nevojë për ndihmë nga shteti. Nga politika e bursave kanë përfituar rreth 11400 studentë dhe kjo ka kapur shifrën e 900 milionë lekëve të rinj. Përgjysmimi total nga tarifa kanë përfituar studentët që kanë përfituar bursa, ekselentët, apo studentët në nevojë dhe përgjysmimi të tarifave kanë përfituar të gjithë studentët e tjerë. Kur them: “Të gjithë të tjerët” flas për studentët e ciklit të parë, pra bachelor, studentët e programeve të integruara, si dhe studentët e programeve master të ciklit të dytë, të cilët i përkasin njërës nga kategoritë që përmenda më lart, si: studentët ekselentë, apo kategoritë në nevojë.

Numri total i studenteve që kanë përfituar nga përgjysmimi dhe përjashtimi i tarifave është 88102 dhe në total janë rreth 90.000 studentë, që kanë përfituar nga politika e përgjysmimit të tarifave, përjashtimi nga tarifat, si dhe bursat në vitin 2019. Kjo është një arritje dhe një ndihmesë e madhe për familjet shqiptare, që kanë fëmijë të moshës studentore.

Një nga kërkesat e studentëve, që u ngrit si çështje e rëndësishme në muajin dhjetor, ishin kushtet, në të cilat jetojnë studentët, që vijnë kryesisht nga familjet në nevojë dhe jetojnë në konvikte. E dimë të gjithë që gjendja e konvikteve, jo vetëm në Tiranë, por sidomos jashtë

Tiranës, ku kemi universitete, nuk ka qenë shumë e mirë. Janë bërë përpjekje ndër vite dhe është ndarë buxhet ndër vite që të investohet nga pak, por duke marrë parasysh që kjo u ngrit si një kërkesë akute e studentëve, ne vendosëm që një pjesë të buxhetit ta alokojmë direkt tek investimet në konvikte. Në Tiranë investimi u bë nga Bashkia e Tiranës, nga një fond i vitit 2018, të cilin arritëm ta ndajmë në fund të vitit 2018 nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, si dhe nga partnerët tanë të zhvillimit, si qeveria gjermane në këtë rast. Në qytetet e tjera jashtë Tiranës kemi filluar investimet në të gjitha konviktet, ku 3 prej konvikteve, në Shkodër, Vlorë dhe Korçë, duke filluar nga ky vit, po bëhen me buxhetin e shtetit, ndërsa Gjirokastra dhe Elbasani kanë filluar tani me një ndihmë nga qeveria turke, nga fondacioni TIKA. Besoj se deri në janar të vitit 2020, tri konviktet, që kanë filluar punimet në muajin shtator do të mbyllen, ndërsa dy konviktet, që kanë filluar në muajin nëntor, do të mbyllen në muajin shkurt të vitit 2020. Kështu që besoj se e mbyllim ciklin e investimeve në konvikte dhe studentët e vitit 2020 do të jetojnë në kushtet, që i meriton një student i kësaj kohe.

Gjatë diskutimeve me studentët kemi folur shumë edhe për qasjen që studentët kanë në literaturë. Pra, nëse duam të përmirësojmë cilësinë e arsimit të lartë, nuk është e rëndësishme vetëm investimi në infrastrukturë, por nevojitet që studentët të ekspozohen nga më shumë materiale, që u nevojiten për të përmirësuar edhe punën që bëjnë në universitet, por edhe kërkimin shkencor që mund ta bëjnë përtej kohës që kalojnë në universitet.

Ka dy mënyra për të investuar në biblioteka: njëra është ajo që bëjnë universitetet, të cilët blejnë libra nga viti në vit, duke u vënë në dispozicion studentëve jo vetëm librat që u duhen për kurse, por edhe libra që u duhen për kërkim shkencor. Ajo që vendosëm ne të bëjmë është vënia në dispozicion e një biblioteke digjitale, e cila nuk kërkon hapësirë fizike, mund të aksesohet nga celulari apo laptopi privat dhe studenti ka qasje në miliona artikuj shkencorë dhe qindra mijëra libra akademikë. Studenti shqiptar, në njëfarë mënyre, bëhet i barabartë me studentët e tjerë në vende të ndryshme të Europës, të cilët janë të ekspozuar ndaj një arsimi me cilësi më të lartë. Biblioteka digjitale u siguroa gjatë këtij viti. Kemi blerë akses për tri vjet dhe është në dispozicion falas për të gjithë studentët dhe kërkuesit shkencorë. Për këtë vit kostoja shkon 14 milionë lekë të rinj, por në total buxheti për 3 vjet do të jetë rreth 600 mijë euro, i cili do të ndahet nga viti në vit dhe do të mbyllet si pagesë përfundimtare në vitin 2022. Ne po mundohemi që të nxisim pedagogët, që edhe ata të nxisin studentët ta përdorin bibliotekën digjitale, sepse, nëse nuk do të jetë kërkesë e pedagogëve, studentët nuk do të jenë shumë të frymëzuar ta përdorin. Ne po shohim sa po përdoret dhe cilat janë revistat që kërkohen më

shumë, në mënyrë që kur të bëjmë kontratën tjetër 3-vjeçare të kemi kërkesa të identifikuar të studentëve shqiptarë dhe ai ose ajo të kenë qasje të dokumenteve që u nevojiten më së shumti.

Kemi pasur një rritje për fondin për kërkimin shkencor, që është i rëndësishëm dhe lidhet direkt me cilësinë e arsimit, sepse, siç e thashë edhe më parë, cilësia e arsimit të lartë ndërlihet direkt me kërkimin akademik dhe kërkimin shkencor.

Fondi, nga 320 milionë që ka qenë në vitin 2018, është dyfishuar, në 650 milionë lekë për vitin 2019 dhe për vitin 2020 parashikojmë një fond të njëjtë. Një risi e vitit 2019 është që një pjesë e këtij granti është dhënë për infrastrukturën e kërkimit shkencor, ku universitetet kanë aplikuar me projekte konkrete për pajisjen e laboratorëve kërkimorë, në mënyrë që të kenë mundësi të blejnë këto pajisje dhe të përmirësojnë punën jo vetëm kërkimore, por edhe akademike brenda universiteteve.

Ne e kemi ndarë buxhetin për të gjitha universitetet, por po ju jap disa nga shembujt ilustrues: qendra laboratorike pranë universitetit të Vlorës, që do të ofrojë edhe analiza kimike, edhe biologjike për të tretët, dhe shpresojmë që të kthehet në fitimprurëse për institucionin; laborator i integruar i veterinarisë pranë UBT-së do të jetë në funksion të rritjes së sigurisë së produkteve ushqimore për përmirësimin e shëndetit të kafshëve. Pra, edhe këta shpresojnë që në një moment ta përdorin jo vetëm për kërkimin shkencor brenda universitetit, por edhe për shërbime për të tretët, i cili do të jetë një burim i të hyrave financiare për ta; tavolina anatomoizmatike, për studime anatomike pranë fakultetit të Infermierisë të universitetit të Elbasanit. Edhe kjo ka të njëjtin funksion. Pra, jemi munduar që t'i orientojmë universitetet të kërkojnë pajisje laboratorike, që i ndihmojnë për kërkimin shkencor, për punën akademike, por edhe për të ofruar shërbime për të tretët, duke integruar arsimin e lartë me tregun e punës, apo tregun në përgjithësi për shërbime të ndryshme që ata mund të ofrojnë.

Ne kemi ndërmarrë edhe një sërë masash të tjera, për të cilat nuk mund të identifikojmë madhësinë e buxhetit që është investuar aty, sepse përfshihen edhe ministri të tjera, të cilat kanë ofruar shërbime, apo kanë mundësuar këto elemente të politikave të tjera të Paktit, por po ju jap disa shembuj. Shembulli i parë është Karta e Studentit, të cilën jemi munduar ta ofrojmë ndër vite për studentët bashkë me universitetet publike. Universitetet e kanë pasur të pamundur ta ofrojnë Kartën e Studentit, kështu që kemi vendosur ta bëjmë me Bashkinë e Tiranës për studentët e Tiranës dhe me Postën Shqiptare për studentët jashtë Tiranës. Karta përfshin jo vetëm shërbime që ofrojnë institucionet e ndryshme publike në nivel kombëtar, sepse ka shërbime që i ofrojnë bashkitë, por ka edhe shërbime, ose produkte të ndryshme që u duhen studentëve që i

ofrojnë operatorët privatë. Të gjitha këto shërbime janë të përfshira te Karta dhe kemi një shpërndarje rreth 25 mijë studentë në Tiranë dhe në qytetet jashtë Tiranës, meqenëse kemi filluar shpërndarjen në këtë vit akademik. Deri sot janë 3500 studentë që e kanë marrë Kartën dhe shpërndarja po vijon edhe tani që flasim; kemi themeluar portalin e transparencës. Ky është një shpenzim i marrë përsipër nga AKSHI. Ky portal shërben për të gjitha buxhetet që kanë universitetet e ndryshme, mënyrën sesi i shpenzojnë dhe përmirësimin e debatit që kemi në lidhje me transparencën financiare të universiteteve publike, e cila ishte një çështje e diskutuar me studentët; kemi blerë qasje te portali, që bën kontrollin e plagjiaturës, të cilin po e pilotojmë tani; nga pranvera kemi nisur punësimin e studentëve ekselentë direkt në administratën publike me një kontratë njëvjeçare, të cilëve do t'u jepet mundësia për të përmirësuar CV-në e tyre, por edhe për të kontribuar në administratën publike. Janë rreth 650 studentë të punësuar deri tani. Ky projekt do të vijojë dhe sa herë të hapet një vend i ri pune në administratën publike, një herë do të vihet në dispozicion të studentëve ekselentë, pastaj do të hapet për punësime të zakonshme të shërbimit civil. Kjo kosto e caktuar mbulohet nga buxheti i përgjithshëm, me të cilin paguhet administrata publike. Kështu që nuk mund të identifikohet si një shifër e saktë dhe nuk është një shifër që mbulohet nga Ministria e Arsimit. Ne mbulojmë praktikën e punës për mësuesin, ku nga viti në vit kemi gjetur hapësirën për 1500 praktikantë, pasi në sistemin parauniversitar janë rreth 1200 mësues, të cilët ose dalin në pension, ose marrin pushim një vit dhe kërkohet zëvendësim me mësues të rinj. Duke marrë parasysh këtë shifër, numri i praktikantëve, të cilët duhet të kryenin praktikën, të merrnin licencën dhe të bëheshin gati për t'u bërë mësues ka shkuar deri në 1500.

Këtë vit, duke marrë parasysh që universitetet kishin diplomuar shumë më shumë mësues dhe ata kërkonin të drejtën që të kryenin praktikën e punës, në mënyrë që të kenë mundësinë të bëhen mësues, numrin e praktikave për mësuesin e rritëm në 2300 dhe kjo kap një vlerë prej 200 milionë lekësh të reja. Kjo është një përgjigje direkte e diskutimeve që kemi bërë me studentët gjatë gjithë vitit, të cilët kanë kërkuar të kenë mundësi ta bëjnë praktikën menjëherë pas diplomimit dhe jo të presin deri sa t'u vijë radha, në një moment të dytë, ku mund të futeshin te numri 1500 siç ishte planifikuar më parë.

Së fundi, për pjesën e Paktit, gjatë vitit kemi bërë diskutime të detajuara me universitetet publike për nevojat e tyre infrastrukturore. Universitete të ndryshme kanë bërë investime në vitet e fundit në masa të ndryshme dhe disa kanë nevojë për shtesa godinash, disa kanë nevojë për rikonstrukcione dhe kemi mbledhur të gjitha projektet, që janë hartuar ndër vite, ku po bëjmë një

plan të detajuar për investimet infrastrukturore në kampuset universitare, jo vetëm në Tiranë, por dhe në universitetet jashtë Tiranës. Në vitin 2020, nga buxheti që parashikohet të mblidhet nga të ardhurat që kanë universitetet publike, si dhe nga buxheti grant që kemi projektuar ne, do të jenë në dispozicion rreth 2 miliardë lekë të rinj për investime infrastrukturore dhe në javët në vijim do të bëjmë një plan të detajuar me universitetet për mënyrën sesi do të shpenzohet ky buxhet.

Buxheti për arsimin parauniversitar në total përfshin një shifër prej 26,9 miliardë lekësh të rinj që kemi parashikuar për vitin 2020 për pagat e mësuesve dhe personelit tjetër arsimor. Pjesa më e madhe e buxhetit na shkon te pagat e mësuesve, ku kemi 31063 punonjës, që paguhen nga ky buxhet. Një premtim që kemi pasur ndër vite, të cilin po e mbajmë dhe po luftojmë fort që të vijojmë ta zbatojmë nga viti në vit është rritja e pagës për mësuesit. Ata kanë një profesion goxha të vështirë dhe puna që bëjnë mësuesit besojmë se duhet të reflektohet edhe në pagë. Rritja e vazhdueshme e pagave për mësuesit në buxhet ka pasur një efekt prej 1,4 miliardë lekësh në vitin 2019, e cila do të reflektohet edhe në vitin 2020.

Gjithashtu në vitin 2020 parashikojmë që të kemi në sistem 1050 mësues ndihmës. Siç e dini, koncepti i mësuesit ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara nuk ka qenë i përfshirë si koncept para vitit 2014. Nga viti në vit ky numër është rritur dhe sot kemi një numër prej 1050 mësuesish ndihmës të parashikuar për vitin tjetër. Kjo na çon te numri 1 mësues për 4 nxënës me aftësi të kufizuara nëpër shkolla, që do të thotë se një numër më i lartë nxënësish jo vetëm po përfshihet në mësim, por po arrijnë të përfitojnë më shumë nga ajo që japin si leksione. Nxënësit me aftësi të kufizuara po arrijnë të kapin potencialin maksimal brenda sistemit arsimor parauniversitar. Efekti buxhetor për mësuesit ndihmës jo vetëm për pagat e tyre, por dhe për trajnimet e vazhdueshme që ata duhet të kenë është rreth 945 milionë lekë, e cila përfshihet te shuma totale që përmenda më lart, prej 26,9 miliardë lekë për punonjësit në arsim.

Tani po kaloj tek investimet. Një projekt i ri, që ka filluar të zbatohet që nga viti 2018, të cilin do ta çojmë deri në vitin 2021 sa të stabilizohet zbatimi i tij, ka të bëjë me tekstet shkollore falas. Nga klasa I deri në IV në vitin 2018 të gjithë nxënësit i kanë marrë tekstet shkollore falas, i cili ka qenë edhe një vit pilotimi, ku kemi parë pak se sa po përdoren dhe po ruhet librat që të ripërdoren vitin tjetër. Sa i takon vitit 2019 kemi përfshirë klasën V, ndërsa për vitin 2020 parashikojmë të përfshijmë klasat VI-VII, ndërsa për vitin 2021 do të përfshijmë edhe klasat e VIII-IX dhe në këtë formë do të mbyllim gjithë ciklin e detyrueshëm me libra falas. Kemi vënë se prindërit dhe nxënësit janë të përgjegjshëm, duke i ruajtur librat në mënyrë që ato të ripërdoren, ndaj do të përfshijmë edhe më shumë nxënës te nisma e librave falas. Sa i takon vitin

2020 parashikohet të kapet vlera prej 584 milionë lekë, duke u mbuluar rreth 250 mijë nxënës, sepse nuk do të mbulohen vetëm nxënësit e klasave I-VII, siç parashikohet për vitin 2020, por edhe të gjithë nxënësit e kategorive të ndryshme, të veçanta që kanë nevojë për asistencë nga shteti.

Sa i takon infrastrukturës shkollore, çdo vit parashikojmë rreth 75 shkolla, të cilat do të rikonstruktohen apo do të ndërtohen nga e para, nga të cilat do të përfitojnë rreth 30 mijë nxënës, me një vlerë rreth 2 miliardë 849 milionë lekë. Duhet të keni parasysh që ka edhe projekte që kanë filluar vitin e kaluar, të cilat do të mbyllen sivjet, kështu që kur të bëjmë thirrje për projekte infrastrukturore për shkolla nga ana e bashkive, kjo gjë duhet të merret parasysh dhe të bëhet një rakordim i buxhetit. Vlen të nënvizoj se në qytetin ku kemi problemin më të madh sa u përket hapësirave shkollore, i cili është Tirana, ka filluar që më parë projekti i “17 shkollave”, i cili nuk do të ketë efekt buxhetor tani, për shkak se investimi në shkolla bëhet nga kompani të ndryshme, të cilat nuk do të paguhet tani, por në vijim, duke zgjidhur përfundimisht problemin e mësimiit me dy turne në qytetin e Tiranës, ku kemi edhe dyndjen më të madhe të nxënësve.

Shkollat që do të rikonstruktohen do të pajisen me mjete didaktike dhe me mobilie, kështu që për vitin 2020 parashikojmë 70 milionë lekë për mjete didaktike dhe 160 milionë lekë për mobilie, pra e njëjta shumë me atë të vitit 2019 me një rritje të vogël.

Sa i takon sportit dhe rinisë, për vitin 2020 parashikohen 486 milionë lekë. Po ju nënvizoj disa zëra kryesorë: për palestra dhe mjedise sportive janë të ndara 266 milionë lekë; financim për shërbimin kombëtar të rinisë janë 70 milionë lekë; për sportistët elitarë, që fitojnë në gara ndërkombëtare janë 30 milionë lekë, por nëse ka më shumë sportistë elitarë, buxhetin do ta rishohim gjatë vitit, kjo është pak a shumë ajo që jepet nga viti në vit; si dhe financimi për federatën sportive me një shumë prej 120 milionë lekë. Dua të nënvizoj që pakoja për sportin, si dhe ligji “Për rininë” do të na ngarkojnë me shtesa buxhetore që do të reflektohen në vitin 2021, megjithatë të gjitha këto do t’i zbërthejmë gjatë vitit 2020 dhe do të kemi rastin t’i diskutojmë bashkërisht në vijim.

Këtu po e ndërpres prezantim fillestar. Jam në pritje të pyetjeve tuaja.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Shahini, për prezantimin që na bëtë për projektbuxhetin e vitit 2020 për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë!

Kam dy gjëra që dua t’i diskutoj dhe më pas do të hapim seancën e pyetjeve nga ana e kolegëve.

Së pari, duke parë shifrat, jam e lumtur që i keni qëndruar angazhimit të ndërmarrë nga qeveria për pjesën e Paktit për Universitetin, një rritje të fondit për arsimin e lartë me 34% në buxhetin e vitit 2020, kjo si reflektim edhe ndaj kërkesave emergjente të studentëve qoftë për pjesën e infrastrukturës, të ambienteve, të kurrikulave, të teksteve dhe mbi të gjitha sa i takon pjesës që ka të bëjë me fondin për kërkimin shkencor si kusht apo parakusht për të pasur një performancë shumë më të mirë të pedagogëve në mësimdhënie.

Nga ana tjetër, ajo çka vlen për t'u theksuar është fakti që, pavarësisht përpjekjeve të bëra qoftë në bashkëpunim me bizneset private, qoftë në bashkëpunim apo në rialokim të fondit që keni pasur në dispozicion, ndryshimet tashmë janë të dukshme. Ajo që dua t'ju kërkoj si ish-pedagoge e Universitetit të Tiranës, është që të kemi një vëmendje më e shtuar se si duhen nxitur pedagogët për të pasur një performancë më të lartë. Nëse te Pakti për Universitetin fokusi kryesor kanë qenë studentët, kjo është mëse normale, dhe si përgjigje ndaj kërkesave të tyre ndryshimet janë të dukshme, por ne duhet të punojmë më shumë sa i takon motivimit të pedagogëve për të pasur një performancë më të lartë. Këtu do të doja një sqarim nga ana juaj sa i takon fondit për shkencën. Në prezantimin tuaj u shprehët se ky fond është rritur, por në totalin e fondit për shkencën ka një ulje. Nuk e di nëse kjo është në zëra të veçantë, sepse ka pasur ulje në total më pas. Ku qëndron problemi i uljes? E para.

E dyta. Sa i takon pjesës së marrëveshjeve që duhen bërë, të universiteteve me ministrinë përkatëse, pasi si ligjvënës e dimë fare mirë që sa herë që vjen një draft apo një projektligj nga ministrinë, gjithmonë duhet të jetë i shoqëruar me një studim për efektivitetin që kanë masat e ndërmarrë kur ligjet hyjnë në fuqi, kemi pasur diskutime sa i takon pjesës së Paktit për Universitetin, ndërkohë që duhet të kishim nënshkrim marrëveshjesh ndërmjet pedagogëve dhe ministrive përkatëse për t'i angazhuar pedagogët në studimet e efektivitetit për projektligje të caktuara dhe po ashtu edhe marrëveshje që duhet të lidhen me biznesin për të vazhduar më tutje dhe për të financuar kërkime të caktuara shkencore që i shërbejnë asaj çka është biznesi sot.

Pjesa e dytë që dua të parashtoj ka të bëjë me pjesën e arsimit parauniversitar. Kemi diskutuar gjatë gjithë kohës për mësuesit ndihmës, për rritjen e pagave të mësuesve gjatë vitit 2018-2019, ndërkohë ajo çfarë duhet të rishihet, këtu kam një pyetje për ju një lidhje me planifikimin që keni bërë sa i takon pjesës së nevojave që kemi për shkolla të reja, sidomos aty ku ka ndryshime demografike dhe ndryshimet që keni bërë në planifikimin e numrit të mësuesve aty ku ka largime të njerëzve nga zona të caktuara. Çfarë jeni duke bërë me klasat që janë të përbashkëta? Si jeni duke i ndryshuar? Ku jemi me pjesën e planifikimit të numrit të tyre?

Pra, kur flas për mësuesit ndihmës, një pikë tjetër këtu ka të bëjë me psikologët. Sot numri i psikologëve që kemi nëpër shkolla është i ulët për numër fëmijësh, prandaj dua të di sa çfarë keni planifikuar sa i takon të ardhmes?

Problematikat që kanë nëpër shkolla fëmijët nuk kanë të bëjnë vetëm me tekstet, por edhe me fenomene të ndryshme sociale që mund t'i prekin. E dyta.

E treta, ka të bëjë drejtpërsëdrejti me qarkun më të madh, ku numri i popullsisë dhe ndryshimet demografike janë më të mëdha, Tirana. Ju përmendët projektin e 17 shkollave. Zoti Roshi, jam e bindur se kjo pyetje do t'ju interesojë. Në Tiranë ka lagje të ndryshme, të cilat për nga numri i popullsisë janë të barabarta me qarkun më të madh në Shqipëri dhe nuk kanë asnjë shkollë. Një prej tyre është zona e Astirit, e cila nuk ka asnjë shkollë, edhe pse ndër vite kemi premtuar që në atë lagje do të ketë shkolla. Unë jam deputete e kësaj zone, por, ashtu siç e përmendi edhe ministrja e Shëndetësisë dhe e Mbrotjtjes Sociale, ka edhe zona të tjera si Kodra e Diellit apo Fresku, në të cilat numri i shkollave ose është shumë i ulët në krahasim me numrin e popullsisë ose nuk ka ende. Meqë ju na folët për projektin e 17 shkollave, dua të di konkretisht se kur fillojnë këto shkolla, sepse nevojat janë imediate.

Ashtu sikundër ne reflektuam si maxhorancë në parlament, ku edhe kolegët e opozitës i kanë mbështetur kërkesat e studentëve, a do të reflektohet me emergjencë në zgjidhjen e këtyre problematikave?

Pra, siç është problem trafiku apo zhvendosja e atyre fëmijëve, është diçka e kushtueshme për familjet e këtyre fëmijëve, pasi u duhet t'i dërgojnë në shkolla të tjera, por nga ana tjetër, siç e dini, ulet edhe cilësia e mësimdhënies në ato shkolla ku numri i nxënësve nëpër klasa është shumë i lartë.

Faleminderit!

Mendoj se do të ishte më mirë që të bëheshin të gjitha pyetjet dhe më pas të përgjigjet ministrja. Si mendoni?

(Diskutime pa mikrofon)

Zonja Hyseni, fjala për ju.

Edlira Hyseni – Mirëdita!

Ne e kemi parë buxhetin edhe me ministren e Financave dhe kemi konstatuar një rritje të buxhetit për vitin 2020, duke e krahasuar me vitin 2019 sa i takon ministrisë së ju drejtoni, Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Pa dyshim, zëri që ka rritjen më të lartë është arsimi universitar dhe më pas janë zërat e tjerë. Në fakt, ajo që bie në sy, pasi kam parë diferencën ndërmjet vitit 2019 me 2020, rritja e konsiderueshme e fondeve është diku te 2,6 miliardë lekë të reja, konsiston në shpenzimet korrente, ndërsa pjesa e investimeve nuk ka një rritje të madhe, por diku te 240 milionë lekë, nëse nuk gaboj.

Në planifikimin që keni bërë dhe kërkesat që po përpiqeni t'i përmbushni, të cilat lidhen me kërkesat e studentëve, nuk e di sesi janë raportet e kërkesave që u janë bërë, realisht rritja është në shpenzimet operative, kurse fondet për zërin e investimeve sa takon arsimit janë rritur shumë pak. Dua të di kush është qëndrimi juaj në lidhje me këtë?

Ju thoni, gjë që është absolutisht evidente, rritja e fondeve ka të bëjë edhe me një angazhim që ju keni marrë, të cilin kërkon ta përmbushni, sa u takon plotësimit të kërkesave të studentëve. Me aq sa kemi dijeni të gjithë, ata ende vazhdojnë të jenë të pakënaqur dhe kërkojnë të shprehin me mënyrat e tyre edhe kërkesa të tjera. A mendoni ju se i keni realizuar kërkesat e tyre që kanë qenë të listuara dhe sa prej tyre kanë mbetur pa realizuar? Unë mendoj se duhet të jemi të sqartë dhe të themi që deri këtu arritur, prandaj, ju lutem, na jepni kohë për ta realizuar pjesën tjetër. Unë mendoj se është shumë e rëndësishme t'u themi se çfarë është bërë dhe t'i pranojmë edhe ato që nuk janë bërë qofshin këto për efekt kohe, buxheti, ato pamundësi që ju i gjykoni si pengesa deri më sot.

Këto vitet e fundit ka pasur disa projekte të granteve të Fondit Shqiptar të Zhvillimit që lidheshin me arsimin, si rikonstruksioni dhe ndërtimi i shkollave të reja për disa bashki të Shqipërisë. Unë di që për qytetin e Durrësit ka pasur fonde dhe si rezultat i këtyre fondeve janë bërë 2-3 shkolla të reja, si dhe disa godina arsimore, por më shumë emergjente është rikonstruksioni i 3 shkollave, si dhe ndërtimi i shkollave të tjera të reja. Dua të di nëse vijojnë projektet që lidhen me grantet që Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka fokusuar te arsimi. A parashikohet të nisin në vitin 2020 apo edhe më tej ndërtimi i objekteve të reja arsimore në rrethet përtej Tiranës, konkretisht në Durrës? Ju përmenda Durrësin, sepse unë jetoj në këtë qytet dhe i njoh shumë mirë problematikat që ai ka.

Një koleg deputet, kryetari i grupit të pavarur ku unë bëj pjesë, ka shprehur në parlament disa herë kërkesën për mundësinë e përjashtimit të TVSH-së së librave që vijnë nga importi, ku shpesh studentët bëjnë blerje *online*. Si rezultat i kësaj është kërkuar dhënia e mundësisë, meqenëse në kohët e sotme dhënia e mundësisë është një praktikë që përdoret nga studentët. Dua

të di nëse keni parashikuar të bëni ndonjë kërkesë apo nëse është e mundur të realizohet përjashtimi i detyrimit të TVSH-së në importin e librave të blerë nga jashtë vendit?

Kam edhe diçka të fundit, pasi më tërhoqi vëmendjen diçka që thatë ju më parë, ku një ndër politikatat e reja që keni ndërmarrë është edhe punësimi i studentëve ekselencë dhe se kjo përbën një kosto. Kjo gjë sipas një logjike të thjeshtë nuk përbën kosto, por një përfitim. Dua të di pse punësimi i studentëve ekselencë është kosto dhe jo përfitim?

Këto ishin pyetjet që unë kisha.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Hyseni!

Zoti Bushi e ka fjalën.

Xhevit Bushaj – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Falënderoj ministren dhe stafin që e shoqëron për ekspozenë që i bëtë një problemi kaq të rëndësishëm, siç është buxheti i vitit 2020.

Pyetjet që unë kam konsistojnë, sepse nuk e di sa jeni në dijeni për kuotën e transportit të nxënësve nëse kilometrazhi është mbi 2 mijë kilometra apo edhe të mësuesve mbi 5 kilometra? Ky është kthyer në shqetësim në zonat që mbulojmë, sidomos në zonat rurale ku për shkak të largësisë shoqëritë e transportit nuk e marrin përsipër këtë lloj shërbimi të nxënësve.

Përveç Tiranës, sepse i dëgjova me vëmendje sqarimet që ju bëtë përveç buxhetit edhe eliminimin e mësimdhënies me turne, ka disa qytete të tjera, siç u shpreh edhe kolegja, sidomos në qytete ku ka lëvizje të madhe demografike, siç është Fieri, në të cilët mësimi bëhet ende me turne.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Bushi!

Zoti Roshi, fjala për ju.

Artur Roshi – Faleminderit!

Zonja Ministre, nuk do të dëshiroja t'ju bëja pyetje si shqiptare e Kosovës për shkak të sensitivitetit që kam ndaj çështjes kombëtare dhe për unifikimin e kombit tonë, por duke u gjendur në këtë pozicion jam i detyruar t'ju adresoj disa pyetje.

Së pari, pse studentët e ekselencës përzgjidhen nga shkollat shtetërore dhe jo nga shkollat private, ku trupa e akreditimit e pajtuar nga Ministria e Arsimit është një trupë ndërkombëtare? Shumë shkolla private vitet e akreditimit apo renditjen në akreditim e kanë më të lartë sesa universitetet shtetërore. Pyetja që unë kam është: pse neve na ka ngelur ora vetëm te shteti si i

vetmi që nxjerr kualitete? Sipas meje kjo gjë duhet të marrë fund, sipas meje, si koncept i së shkuarës, si dhe gjej rastin t’ju them që duhet të kemi një fillim të ri ndryshe nga ajo që kemi pasur deri më sot.

Si i përzgjidhni ju tekstet shkollore? A jeni e bindur që fëmijët tanë mësojnë historinë e vërtetë të kombit shqiptar? Unë kam bindjen që jo, për këtë do t’ju kërkoj një interpelancë për të qenë më të saktë dhe më të detajuar. Të gjithë e dimë që historia jonë ka prodhuar mite dhe ka ekzistuar mbi bazën e miteve false. Dua të di se ku konsiston puna e Ministrisë së Arsimit për t’iu afruar realiteteve historike dhe jo realiteteve politiko-historike të ngritura mbi pushtete, të cilat nuk u kanë shërbyer shqiptarëve.

A mund të ketë Ministria e Arsimit një çmim në fushën e letërsisë, gjuhës, diplomacisë apo në ndonjë fushë tjetër që ju mund ta shihni të arsyeshme dhe ta quani çmimi “Mit’hat Frashëri”? Pse ua them këtë? Ju e dini që baza e gjuhës mbi të cilën komunikojmë sot bashkë kryetar i Kongresit të Manastirit ka qenë Mit’hat Frashëri, pra është firma e tij që ka bërë njësimin e gjuhës shqipe, njësimin kulturor kombëtar. Gjuha është identitet kombëtar, një nga elementet, dhe në këtë kontekst njeriun, i cili ka vënë gurin e parë të themelit ne nuk e vlerësojmë me çmime të ndryshme nëpër shkollat tona qofshin ato të mesme apo universitare. Para disa ditësh kam dëgjuar një intervistë të rektorit të universitetit, zotit Maliqari, i cili ankohej se Instituti i Sizmikës, për të mos thënë emërtesën shkencore Instituti i Gjeoshkencës nuk ka mjetet e duhura të përputhura me teknologjinë e kohës për të matur parametrat e lëkundjeve sizmike, sigurisht kjo merr shkas edhe nga tërmeti i fundit që ka rënë. Këto janë disa qendra studimore të atashuara brenda universiteteve, të cilat nuk funksionojnë, përveçse marrin pagesa në mënyrë parazitare (më vjen keq që ta them këtë). Ne duhet t’i stimulojmë ata që të mos mbeten thjesht vetëm në kuadrin e pagesave, por të marrin përsipër nisma të ndryshme shkencore, të cilat i interesojnë biznesit dhe të futen në marrëdhënie të drejtpërdrejta me ta. Pra, pjesa e aparaturave të Institutit të Gjeoshkencës është shumë e rëndësishme të rregullohet që ne të ndjehemi të rehatuar.

Tërmetet nuk mund të parashikohen por duhen aparaturat për të krijuar një *database* historik të tërmeteve që do të bien për 50 apo 100 vitet që do të vijnë.

Ju faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Roshi!

Fjala për zonjën Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit!

Kisha një sërë pyetjesh, në fakt, që lidhen me paktin për universitetin, por pjesën më të madhe të përgjigjeve e mora, sepse prezantimi i zonjës Ministre ishte shterues, kështu që do të ndalem vetëm në një pyetje që lidhet me shqetësimin që vjen nga stafet akademike apo të sapodiplomuarve në master shkencor në programe të ndryshme studimi në të gjithë vendin dhe që kanë dëshirë të vazhdojnë studimet në ciklin e tretë të doktoraturës.

Ne e dimë problematikën që kanë shfaqur ndër vite studimet e doktoraturës dhe jemi të ndërgjegjshëm për arsyet pse u pezulluan për disa vite. Të rinjve që dalin me rezultate të shkëlqyera dhe kanë dëshirë të vazhdojnë studimet e doktoraturës, u është mohuar kjo e drejtë. Një pjesë detyrohen të shkojnë jashtë shtetit, një pjesë tjetër kanë të drejtë për të vazhduar dhe për të qenë pjesë e stafeve akademike, mirëpo kriteri është që duhet të jesh ose me doktoraturë, ose të paktën në proces doktorature. Pyetja ime lidhet specifikisht me këtë çështje: kur do të hapen shkollat e doktoraturës?

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Fjala për zonjën Topi.

Suzana Topi – Faleminderit, zonja Ministre!

Pyetjet e mia janë dy-tri dhe unë po fokusohem në to: a keni një qëndrim për Kopshtin Botanik, i cili është objekt midis bashkisë dhe universitetit? Cili është qëndrimi juaj?

E dyta, megjithëse keni një rritje të buxhetit për vitin 2020, a është i mjaftueshëm ky buxhet për një arsim cilësor, laboratorë cilësorë të kërkimeve shkencore, ndërkohë që ishte premtuar që kjo të ishte 5 % e prodhimit të brendshëm bruto?

E treta, karta e studentit, mendoni se e lehtëson barrën ekonomike të tyre? Ju thatë se disa konvikte janë drejt procesit të rehabilitimit. Dua të pyes edhe për konviktet në rrethe: në ç'gjendje janë, a ka rikonstruksione në to?

Për sa i përket Paktit të Universitetit, do të doja të dija nëse do të ketë përgjysmim të tarifës së studentëve në përgjithësi për bachelorin dhe masterin, sepse, në këndvështrimin tim dhe atë çfarë ju thoni, po u jepet vetëm studentëve të ekselencës.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Topi!

Fjala për zonjën Dhima.

Antoneta Dhima – Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre, për prezantimin!

Kam disa pyetje: e para, për sportin dhe rininë, që është një nga prioritetet e ministrisë suaj. Një prioritet është përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve. Cilat janë mekanizmat që do të përdorni për të realizuar këtë prioritet?

Gjithashtu, në fushën e arsimit profesional, prioriteti i ministrisë suaj është rritja e numrit të të diplomuarve në shkollat e mesme profesionale. Lidhur me numrin e nxënësve që vijnë nga zonat rurale dhe ndjekin arsimin profesional, apo numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar, cilat janë instrumentet që do të përdorni ju si ministri në bashkëpunim me Ministrinë e Financave?

Në vijim të fjalës së kolegut Bushaj, për problemin e transportit të nxënësve që kanë vendbanimin mbi 2 kilometër larg shkollës dhe njëkohësisht edhe të mësuesve që përshkojnë një distancë mbi 5 kilometër nga vendbanimi i tyre, sipas informacionit që kam, në vendimin e Këshillit të Ministrave tarifat janë shumë të ulëta. A keni mundësi ta rishikoni vendimin për këto tarifa, pasi ato janë shumë të ulëta krahasuar me çmimet e tregut?

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Dhima!

Fjala për zotin Ryçi.

Krenar Ryçi – Faleminderit, zonja drejtuese!

Faleminderit, zonja Ministre!

Jam dakord me të gjitha shpjegimet që paraqitët, siç jam dakord edhe me kolegët deputetë që parashtruan kërkesat e tyre lidhur me çështjen.

Kam një merak në lidhje me Universitetin “Vitrinat”, i cili është mbyllur. Atje studioan mbi 4 apo 5 mijë studentë të bachelorit, të cilët kanë bërë një pagesë dhe kanë marrë një dokument të pavlerë që nuk mund t’ju shërbejë për të ardhmen. Ata sot kanë ngelur rrugëve. Ne si prindër kemi bërë gjithë atë investim lidhur me mësimdhënien në këtë universitet dhe kjo ka ndikuar edhe në ekonominë e familjes. Familje me halle e sakrifica kanë paguar për të shkolluar fëmijët dhe nuk kanë marrë atë që u takonte. Duke qenë se ky universitet ka qenë i licensuar nga ministria, dua të di a do të merret ndonjë masë, a do të shihet si prioritet në të ardhmen e afërt?

Së dyti, në lidhje me shkollat e mesme, celularët që përdoren gjatë orëve të mësimi herë pas here janë bërë problematikë dhe shqetësim për mësuesit, këtë gjë e di pasi kam edhe bashkëshorten mësuese. Çfarë do të bëhet lidhur me këtë shqetësim?

Pyetja tjetër ka të bëjë me drogën, e cila është bërë gangrenë për shkollat e mesme, sidomos ato parauniversitare apo edhe nëntëvjeçare. A keni ndonjë plan konkret masash për të parandaluar këtë fenomen? Meqenëse jeni pjesë e qeverisë, do të ishte e udhës që në këto shkolla

të ketë forca policore dhe jo policë privatë, pasi me këta të fundit nxënësit bëjnë marrëveshje, madje edhe nga jashtë shkollave futen njerëz që u bëjnë presion studentëve apo nxënësve. Keni ndonjë parashikim lidhur me to, në mënyrë që shkollat të jenë sa më funksionale, të ketë kontroll në mënyrë që të krijohet besimi edhe te prindërit, që gjithmonë shoqërojnë fëmijët e tyre pasi u ka humbur besimi.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Ryçi!

Zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit!

Pyetjen e parë lidhur me transportin e nxënësve me banim larg nga shkollat e konsumoi kolegu. Ky është bërë problem sidomos në zonat rurale, pasi ka fshatra ku numri i fëmijëve që frekuentojnë shkollën ka rënë shumë, interesi i transportuesve gjithashtu ka rënë. A keni parashikuar në këtë buxhet diçka për të parandaluar këtë problem që kanë fshatrat në zonat e thella malore?

Problemi i dytë lidhet me sportin. Buxheti për sportin dhe investimet për të, më duket shumë i ulët. Në bashkinë e Selenicës ka një ekip futbollit, i cili nuk ka as fushë minimalisht, kështu që do të kërkoja nga ministria juaj të shikojë mundësinë e vendosjes në buxhet të një investimi për ekipin e futbollit të kësaj bashkie.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit!

Fjala për zotin Hysko.

Eljo Hysko – Faleminderit!

Doja të dija me çfarë formule bëhet shpërndarja e investimeve për rindërtimin apo rikonstrukcionin e shkollave? A keni një raport në bazë qarqesh dhe bashkish për shkollat që janë me dy turne? A keni një strategji deri kur do të marrë fund ky fenomen, që ta dimë që për iks vite nuk do të ketë më shkolla të tilla?

E dyta, për sa i përket sportit, cila është strategjia për përfshirjen e të rinjve në sport? A keni disiplinë të caktuar në këtë fushë? Duke marrë shkas nga një investigim në terren, shumica e shkollave në bashkinë që mbuloj unë në zonën time elektorale, kanë kushte jo të mira sportive. Fusha pa porta, palestra, të cilat kanë nevojë për rikonstrukcion. A ka një plan apo një strategji për ndërhyrjen në këto shkolla?

Gjëja tjetër ka të bëj me transparencën. Një nga problematikat që kam hasur qoftë nga studentët, qoftë nga aktivistë të ndryshëm ka qenë transparenca e buxheteve të universiteteve. Ju thatë se po ndërtoni një portal për transparencën, që është për t'u përgëzuar. A mundet t'i nxisim universitetet që të bëjnë buxhetim me pjesëmarrje, pra siç funksionon në institucionet e bashkive, që janë të detyruara të bëjnë komunikim me grupe të ndryshme interesi? A mund të bëjmë të njëjtën qasje për universitetet? Pra, trupat universitare duhet të kenë një llogaridhënie para studentëve për t'u thënë se ku po i shpenzojnë të ardhurat që marrin dhe së bashku të kenë prioritizim të nevojave të trupës akademike, atyre që administrojnë universitetin, por edhe të nevojave që kanë studentët sipas bindjeve që kanë.

Sa u përket zyrave të karrierës, cila është performanca e tyre në nivel fakultetesh dhe universitetesh? A konsiderohet ajo një histori suksesi? A e keni menduar t'i ndërlidhni ato me zyrat e punës që të kthehen në zyra të mirëfillta pune duke bërë të mundur që studentët qoftë në nivelin bachelor, kur bëhet fjalë për punë *part-time*, qoftë për nivelin master, kur bëhet fjalë për punësim *full-time*, të jenë më interaktivisht dhe më shpejt të lidhur me tregun e punës, qoftë për sa i përket shtetit në rastin e ekselentëve, qoftë edhe për fusha të tjera?

Ndërkohë, një nga zotimet që kemi ndërmarrë si qeveri që prej vitit 2013 ka qenë ndërtimi i 12 qendrave rinore, minimalisht 1 për çdo qendër qarku. Në çfarë pike jemi lidhur me to? A keni parashikuar ndërtimin e një qendre të tillë? A mendoni se ka ardhur koha që përveçse të rindërtojmë konviktet në Qytetin Studenti, të fillojmë të ndërtojmë një koncept të ri të angazhimit dhe ndërlidhjes duke filluar së paku nga një qendër multifunksionale, e cila mund të shërbejë si një qendër studimi, hapësirë rinore ku zhvillohen *workshope*, si qendër teknologjie, në mënyrë që Qytetit Studenti të kalojë nga një hapësirë e fjetur, në hapësirë aktive. Aty nevojitet një tjetër qasje, ku duhet të vibrojnë aktivitetet për të rinjtë, të jetë një hapësirë që mund t'u ofrojë më shumë gjëra për studentët dhe t'u përmirësojë cilësinë e jetës.

Me thënë të drejtën, duhet përgëzuar qeveria dhe bashkia për investimet që po bëhen atje.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Para se t'ia japim fjalën ministres për të kthyer përgjigje, kemi dy shtesa pyetjesh një nga zonja Hyseni dhe një nga zoti Sinaj. Ju lutem, bëni pyetjet në mënyrë të përmbledhur, pa parantezën.

Faleminderit!

Edlira Hyseni – Më erdhi në mend një pyetje shumë konkrete dhe e thjeshtë: Bashkia e Durrësit së fundi oborret e shkollave të mesme, që ishin paraprakisht të sistemuara në fusha

tenisi e të tjera, ua ka dhënë privatëve për t'i shfrytëzuar për sporte të ndryshme. A jeni dakord dhe a keni një opinion për këtë?

Ju faleminderit!

Vullnet Sinaj – Ndjesë që e mora fjalën dy herë!

Në zonën time janë dy sportistë, njëri është kampion në peshëngritje që nuk trajtohet me pagesë, dhe tjetri, Edi Shehaj, në datën 1 dhjetor ndeshet për kampion bote në kik boks. Të dy këta nuk marrin asnjë trajtim nga shteti. Janë sportistë që e zhvillojnë sportin vetëm duke u mbështetur te forcat e tyre familjare. Si mund t'i lëmë këta sportistë që nderojnë vendin pa një suport? A është e mundur të krijohet një hapësirë në ligj apo në vendimin e Këshillit të Ministrave për t'iu dhënë mundësinë këtyre kampionëve? Në qoftë se nuk kemi mundësi për të gjithë sportistët, do ta kuptojmë, por të paktën për kampionët e vendit që ngrenë lart emrin e vendit tonë në arenat ndërkombëtare duhet të gjendet një mundësi. Kur jepet mundësia për të ndihmuar studentët ekselentë, jam i mendimit të gjejmë një mundësi për t'i shpërblyer apo sugjestionuar edhe këta sportistë që dalin kampionë Europe apo kampionë bote. Vendet e Ballkanit apo edhe Kosova ua japin ndihmën këtyre kampionëve. Pse të mos e bëjmë edhe ne këtë? Ndodhemi para një problemi të madh ku kemi të bëjmë me sportistë në nivel kampion bote.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Sinaj!

Zonja Ministre, së pari do t'ju kërkoja të gruponit pyetjet dhe përgjigja të jetë në bazë të grupimit, sepse kishte disa pyetje që i mbivendoseshin njëra-tjetrës. Ju lutem shkurtimisht për secilën pyetje, pa përmendur emrin e çdo deputeti, në mënyrë të tillë që të kemi mundësinë që çdo përgjigje të shterojë të gjitha argumentet që ngritën kolegët.

Besa Shahini – Faleminderit për pyetjet, sepse na mundësojnë të thellohem më tepër, të zbërthejmë të gjithë politikën që po synojmë të ndërmarrim në buxhetin e vitit 2020 dhe të sqarojmë disa nga çështjet që ndoshta ishin të paqarta.

Ne jemi ministria e të rinjve dhe fëmijëve, kështu që për të gjitha politikën që po ndërmarrim, i gjithë buxheti është në dispozicion të përmirësimit të eksperiencës studentore dhe shkollore, siç kemi vendosur edhe për ligjin për të rinjtë që duan të rrisin përfaqësimin dhe vetorganizimin e tyre në organizata të ndryshme. Kështu që shpresoj që me shtesat buxhetore do të jemi edhe më të suksesshëm gjatë vitit 2020, siç ishim gjatë këtij viti që po ikën.

Një sqarim për shkollat profesionale: ato mbulohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Ajo që u mundova të sqaroj në fillim ishte se shkollat profesionale dhe parashkollore

që mbulohen nga bashkitë, nuk do t'i reflektoj te prezantimi im, për shkak se kam përshtypjen se keni pasur edhe bashkitë në diskutim por edhe Ministrinë e Financave.

Lidhur me përgjysmimin e tarifave dhe investimet për konviktet jashtë Tiranës, edhe këtu dua të përsëris edhe një herë, ekselentët dhe kategoritë e studentëve në nevojë kanë marrë bursë dhe përjashtim nga tarifa. Janë rreth 11 mijë studentë, ndërsa mbi 80 mijë studentë të tjerë, të ciklit të parë bachelor të integruar kanë marrë përgjysmim të tarifave. Vitin e parë 2018-2019 kanë qenë të gjithë, në vitin akademik 2019-2020 ata do të duhet ta kenë notën mesatare minimalisht 6. Ne duam t'i stimulojmë studentët të studiojnë dhe prandaj kemi vendosur notën mesatare 6, por të gjithë përfitojnë nga përgjysmimi i tarifës dhe nuk ka kthim pas te kjo politikë. Pra, kemi parashikuar për vitin 2020 të gjithë buxhetin që na duhet për të subvencionuar studentët dhe familjet e tyre për përgjysmimin e tarifave.

Nëse ekselentët janë kosto-përfitim, dua të theksoj se janë punësuar 650 studentë ekselentë. Koston nuk mund ta identifikojmë shumë saktë për shkak se janë punësuar në sektorë të ndryshëm të ministrive, kurse për sa i përket përfitimit për ne ka qenë përfitim i jashtëzakonshëm, sepse ka rifreskuar administratën publike dhe kanë sjellë energji dhe metoda të reja të punës. Nga eksperiencia personale që kam në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, punësimi i studentëve ekselentë ka sjellë me të vërtetë një frymë të re. Gjithashtu, kam dëgjuar edhe nga ministritë e tjera që studentët ekselentë kanë sjellë me të vërtetë një frymë të re në mënyrën e funksionimit të administratës.

Për sa i përket pyetjes pse studentët ekselentë orientohen drejt publikut dhe jo privatit, këtu dua të bëj lidhjen edhe me pyetjen për një universitet që është mbyllur. Kemi dhjetëra të tillë. Në të kaluarën kemi pasur një situatë që universitetet janë udhëhequr në mënyrë komplet të papërgjegjshme dhe kanë dhënë diploma pa u bërë studimi, por pas një inspektimi serioz dhe rigoroz, që është bërë në vitin 2014, këto universitete janë mbyllur.

Diplomat e studentëve, të cilët kanë qenë të regjistruar gjatë kohës kur universiteti apo programi ka qenë i akredituar dhe i licencuar, vlejnë. Është dashur që studentët e tjerë të transferohen tek universitetet e vlefshme në kohë. Ata që nuk kanë arritur ta bëjnë këtë gjë, që nuk kanë dashur ta bëjnë këtë gjë, ose ata që pretendojnë se kanë një diplomë, por nuk gjendet në regjistrat e universiteteve, sepse ka pasur ndonjë falsifikim, nuk mund të marrin zgjidhje. Mbyllja e universiteteve është bërë edhe për të vendosur rend dhe rregull në arsimin e lartë. Unë mendoj që kjo e ka prishur pak reputacionin e sektorit privat të arsimit të lartë, i cili po përmirësohet nga dita në ditë. Pra, institucionet e mbetura të arsimit të lartë kanë vendosur të

akreditohen, po investojnë në akreditimin e programeve dhe po mundohen ta mirëmbajnë cilësinë. Ne do të vijojmë të inspektojmë, sepse duam të sigurohemi që studentët nuk do të dëmtohen më në të ardhmen, siç janë dëmtuar nga këto universitete në të kaluarën.

Për sa i përket pyetjes për psikologun në shkollë, kemi nevojë të shtojmë numrin e psikologëve dhe punonjësve socialë, si dhe numrin e oficerëve të sigurisë. Oficeri i sigurisë është një ndihmesë sidomos për ato shkolla që kanë një numër më të madh të nxënësve dhe shkollat e mesme, në mënyrë që të parandalohen dukuri të ndryshme negative që mund të ekzistojnë në shkolla. Sot 150 shkolla e kanë oficerin e sigurisë. Është projekt që po funksionon mirë dhe duam ta zgjerojmë në vitin në vijim.

Do të dyfishojmë numrin e psikologëve dhe punonjësve socialë, por duhet që edhe universitetet të përgatisin psikologë dhe punonjës socialë përkatës në mënyrë që të kemi mundësi t'i punësojmë. Gjithsesi, kemi ndërruar formulën me të cilën caktojmë një psikolog për numër nxënësish: ka qenë 2500-3500 nxënës, tani e kemi zbritur në 1000 nxënës. Edhe kjo nuk e zgjidh problemin, prandaj do ta bëj një diskutim tjetër për këtë. Nëse e zbresim në 1000 nxënës shkollat e mëdha do ta kenë psikologun me kohë të plotë. Gjithashtu, edhe shkollat me numër të vogël nxënësish do të kenë një psikolog që i viziton të gjithë. Kështu që, do ta marrim edhe këtë element parasysh kur të bëjmë formulën e ndarjes, që të mos ketë vetëm numrin e nxënësve, por edhe distancën nga ku është i vendosur psikologu, sepse duam me të vërtetë që fëmija me aftësi të kufizuara në shkollë të mbështetet jo vetëm përmes mësuesit ndihmës, por t'i ofrohet i gjithë shërbimi psikosocial për të cilin ka nevojë dhe që sot kemi mundësi t'ua ofrojmë.

Për sa i përket infrastrukturës shkollore dhe mënyrës si ajo funksionon (një pjesë e shërbime janë decentralizuar në Republikën e Shqipërisë), infrastruktura shkollore është përgjegjësi e bashkive. Sot bashkitë bëjnë identifikimin e nevojave, shkruajnë projektet dhe sjellin aplikimet te Ministria e Arsimit për të bërë një rakordim të të dhënave dhe për të zgjedhur projektet që do të financohen. Bashkitë janë të obliguara që një pjesë të financimit ta mbulojnë edhe vetë. Pra, nëse ne mbulojmë 60-80%, pjesën tjetër duhet ta mbulojnë bashkitë. Kështu që, një pjesë e madhe e pyetjeve që kanë të bëjnë me infrastrukturën kanë të bëjnë me këtë. Bashkitë që janë gati me projekte të mira (po flasim për shkolla të mëdha ku numri i nxënësve nuk ka rënie drastike dhe që kanë nevoja emergjente për investime), kanë gjithmonë prioritet. Kriteret që ne marrim parasysh janë nevojat për investime, amortizimi i shkollës, si dhe numri i nxënësve përfitues në atë zonë për atë shkollë specifike.

Unë besoj se Tirana do ta zgjidhë në 3 - 4 vjetët e ardhshëm problemin e mësimit me dy turne, sepse projekti i 17 shkollave, nga të cilat katër kanë filluar, dy janë kontaktuar, kurse të tjerat do të kontraktohen në vijim, ka filluar të zbatohet. Me ndërtimin e 17 shkollave mbulohen edhe zonat, që përmendi zonja Gjylameti, të cilat nuk kanë pasur shkolla, por kanë një numër të madh të popullsisë. Hartën e shkollave mund t'ua vëmë në dispozicion në ditët në vijim. Tirana zgjidhet me këtë projekt, kurse për sa i përket Durrësit, unë kam folur me kryetaren e bashkisë, por kam njoftuar edhe kryetarët e tjerë të bashkive, që sivjet do ta hapim thirrjen për investime në shkolla në dhjetor. Në momentin që do ta kemi të dakordësuar projektbuxhetin dhe e dimë përafërsisht sa është buxheti përfundimtar, ne do të hapim thirrjen që bashkitë të jenë gati me projektet e tyre dhe ne të fillojmë procesin e vlerësimit të këtyre projekteve. Kështu që, bashkia Durrës, por edhe bashkitë tjera janë të mirëpritura të sjellin projektet për shkollat e tjera që kanë nevojë për investime.

Çështja e transportit të nxënësve dhe mësuesve është çështje e vjetër. Shuma me të cilën ne subvencionojmë nxënësit për transportin në shkollë nuk është gjithmonë e mjaftueshme që të ketë transport të sigurt. Jemi të vetëdijshëm për këtë gjë, por duhet të ndryshohen një seri aktesh nënligjore dhe vendime ku përfshihen edhe ministri të tjera. Ne kemi bërë përpjekje në të kaluarën, do të bëjmë përpjekje përsëri, por na duhet edhe ndihma juaj për ta ngritur vazhdimisht këtë çështje, sepse ka efekt të madh buxhetor. Tarifat e përgjithshme për subvencionim të kostove të transportit, jo vetëm për çështje arsimore, por edhe të tjera, përcaktohen nga ministria që mbulon infrastrukturën dhe transportin. Kështu që, do të duhet një rakordim midis asaj ministrie, Ministrisë së Financave të Ekonomisë dhe ministrisë sonë në mënyrë që të arrijmë të rrisim subvencionimin e transportit. Është një diskutim i gjatë, i thellë dhe na duhet ndihma juaj për ta çuar përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Blerina Gjylameti – Zoti Roshi, ia kërkuam vetë që t'i gruponte.

Zonja Ministre, zoti Roshi e kishte fjalën që të fokusohuni te pyetjet e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por jo të opozitës, sepse deri tani për opozitën po kthente përgjigje. Ishte duke u kthyer përgjigje pyetjeve të zonjës Hyseni, zonjës Topi dhe për dy pyetje që bashkoheshin me të maxhorancës.

Ju lutem, vazhdoni!

Ndoshta mund të ndryshoni pak radhën e përgjigjeve, meqenëse zoti Roshi kërkon pak preferencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ministre, ju lutem, vazhdoni me përgjigjet!

Faleminderit!

Besa Shahini – Më pyetët për universitetin privat “Vitrina” dhe unë u përgjigja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

U përgjigja pse studentët ekselentë shkojnë në universitetet publike dhe jo private. Shkojnë në universitetet publike për shkak të reputacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Studenti ekselent shkon në universitet publik për shkak të reputacionit shumë më të mirë sesa privati, për shkak të dëmit që është shkaktuar nga universitetet e papërgjegjshme në të kaluarën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Thatë që nuk po u përgjigjem pyetjeve të opozitës, por fola për përgjysmimin e tarifave, për investimet në konvikte, për investimet në Durrës, pra, u përgjigja të gjitha pyetjeve të opozitës.

Blerina Gjylameti – Zonja Shahini, jua shpjegova ku qëndron kritika e zotit Roshi. Ka të bëjë me përgjigjet ndaj pyetjeve të tij.

Besa Shahini – Unë do t’i marr pyetjet me radhë, ashtu siç i kam shënuar, që të mos lë askënd pa përgjigje.

Për sa i përket pyetjes nëse është rritur apo zvogëluar buxheti i kërkimit shkencor, dua t’ju them se nga viti 2018 deri në vitin 2019 është dyfishuar, sepse e kemi parë të rëndësishme të rritet buxheti për kërkimin shkencor dhe infrastrukturën e kërkimit shkencor. Këtu shikohet një ulje e lehtë për vitin 2020, por që unë besoj se do ta rregullojmë në vijim. Rritja është dyfishim nga viti 2018 dhe do të vijojë edhe në vitin 2020. Kjo lidhet edhe me çështjen për instrumentet që mungojnë në disa institute. Unë besoj që kur të hapim thirrjen për investime në infrastrukturën e kërkimit shkencor duhet që edhe këto universitete të aplikojnë me projekte konkrete, sepse besoj se do të futen te grupi i investimeve për pasurim të laboratorëve.

Për sa i përket pyetjes sa janë plotësuar kërkesat e studentëve, kërkesat konkrete të studentëve janë plotësuar gati të gjitha: përgjysmimi i tarifave, bursat për ekselentët dhe studentët në nevojë, portali i transparencës, që do ta adresoj në fund, sepse do t’i jap pak

përparësi listës së pyetjeve, pasurimi i bibliotekave. Ne i kemi vënë në dispozicion bibliotekën dixhitale, që është jashtëzakonisht moderne dhe i vendos të barabartë me studentët në vende të tjera europiane. Gjithashtu po investohet në konvikte dhe është bërë plan konkret për investim në kampuset universitare.

Një element që kemi hasur vështirësi në zbatim ka të bëjë me kontrollin e integritetit të kërkimit shkencor të pedagogëve. Kjo ka të bëjë ekskluzivisht me mungesën e bashkëpunimit që kanë treguar universitetet. Ne u kemi kërkuar të sjellin disertacionet në ministri që ne të bëjmë kontrollin, por nuk i kanë sjellë. Kanë sjellë letra të detajuara se si autonomia universitare nuk lejon që ministria të bëjë kontroll mbi diçka që ka dhënë universiteti. Kështu që, ne bëmë pjesën e vetme të mundshme, blemë softin që bën kontrollin për plagjiaturë dhe do t'i mbikëqyrim me shumë kujdes universitetet derisa të bëjmë këtë kontroll. Kështu që, kemi ndërruar mënyrën si do ta bëjmë këtë kontroll, sepse universitetet nuk bashkëpunuan dhe me të drejtë thanë që kjo i përket autonomisë universitare dhe nuk mund të bëhet nga një institucion shtetëror ose qeveritar.

Për sa i përket ciklit të tretë të studimeve, jemi në pritje të përfundimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, që mundëson hapjen e doktoraturave dhe masterëve ekzekutivë, dy programe të reja që do të hapen në të gjitha universitetet. Nuk do të ketë shkollë doktrale, sepse, siç jeni në dijeni, ligji për arsimin e lartë parashikon që tani doktoraturat bëhen duke i atashuar doktorantët në projekte kërkimore të financuara. Kështu që, universitetet duhet të sjellin projekt kërkimor të financiar, ku do të atashohen doktorantët, të cilët në fund do të marrin doktoraturën. Është çështje ditësh që ne të mbyllim të gjithë bazën ligjore që u mundëson universiteteve të sjellin aplikimet te ne.

Për sa i përket TVSH-së së librave, këtë çështje e ka marrë përsipër ta adresojë Ministria e Kulturës dhe ajo e Financave. Është Ministria e Kulturës ajo që merret kryesisht me librat, jo vetëm akademikë, por edhe librat artistikë.

Për sa i përket pyetjes për portalin e transparencës për studentët dhe nëse studentët mund të marrin pjesë në bërjen e buxheteve, dua të nënvizoj edhe një herë se institucionet e arsimit të lartë janë organizata autonome. Për mënyrën si ato e ndajnë dhe vendosin për buxhetin, është senati që vendos për prioritetet dhe pastaj bordi vendos si ndahet buxheti. Unë mendoj që këshillat studentore duhet të jenë të përfshira, kurse e bëjnë apo jo universitetet mbetet në tagër universiteteve.

Për sa i përket kërkesës së studentëve për ndërrimin e anëtarëve të bordeve që ishin përzgjedhur nga ministria më përpara, ne i ndryshuam të gjithë dhe bëmë një proces të hapur të

aplikimit, ku anëtarë të rinj të bordeve janë përzgjedhur persona publikë. Unë besoj që studentët kanë qasje më të mirë tek anëtarët e bordeve që të mund të bëjnë edhe këto kërkesa direkte në universitete. Një pjesë e madhe e këtyre punëve duhet të bëhen nga universitetet.

Për sa i përket pyetjes nëse buxheti është i mjaftueshëm, nuk mjafton kurrë buxheti për gjërat që duam të bëjmë. Unë jam e lumtur që kemi pasur rritje të buxhetit në vitin 2019, por edhe që do të kemi përsëri në vitin 2020. Shikoj që gjërat që po mundohemi të realizojmë do t'i arrijmë, nëse jo në vitin 2020, brenda vitit 2021. Kështu që, e kemi të qartë rrugën dhe mënyrën si do të financohet e gjithë politika jonë për përmirësimin e cilësisë së arsimit, eksperiencës studentore, por edhe eksperiencës së nxënësve në shkollat tona.

Blerina Gjylameti – Zonja Topi donte një opinion tuajin, nëse keni, për debatin ndërmjet Universitetit Bujqësor dhe Bashkisë së Tiranës për Kopshtin Botanik.

Besa Shahini – Nuk është Universiteti Bujqësor, por është debat ndërmjet Fakultetit të Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës dhe Bashkisë Tiranë. Kopshti Botanik është një perlë, që i nevojitet Fakultetit të Shkencave të Natyrës për të kryer jo vetëm kërkim shkencor për të ardhmen, por edhe për të bërë të gjithë punën akademike me studentët. Nga bisedat e shumta që kemi pasur me rektorin, dekanin dhe persona që punojnë në Kopshtin Botanik, ata janë shprehur shpesh që nuk kanë mjaftueshëm as burime njerëzore dhe as financiare ta mirëmbajnë në mënyrën siç duan apo edhe ta pasurojnë me elemente të reja që ju duhen. Bashkia e Tiranës ka thënë që ata e kanë bazën materiale dhe financiare në ndihmë të Kopshtit Botanik, rrjedhimisht në ndihmë të Universitetit të Tiranës. Pra, diskutimi ka filluar kështu, ekziston një nevojë për investim dhe ekziston një institucion që mund ta bëjë këtë investim. Që ky investim të bëhet, prona nuk duhet të jetë e menaxhuar nga universiteti, por duhet të jetë në menaxhim të institucionit që po e bën investimin. Pas shumë bisedash kemi ardhur në përfundim që Bashkia e Tiranës duhet ta ketë në menaxhim Kopshtin Botanik në mënyrë që t'i vijë në ndihmë Universitetit të Tiranës. Ndaj, kemi bërë hapin për ta kaluar administrimin nga Universiteti i Tiranës te Bashkia e Tiranës. Është e rëndësishme të nënvizohet që nuk ka qenë kurrë pronë e Universitetit të Tiranës, por pronë publike dhe shteti ka tagrin ta kalojë aty ku e shikon të nevojshme për t'u bërë investimet për të mirën jo vetëm të studentëve, por besoj të gjithë publikut.

Blerina Gjylameti – Ne ndajmë mendime dhe opinione të ndryshme, por shkurtimisht ky ishte opinioni i ministres.

Zonja Ministre, keni edhe dy pyetje të zotit Hysko që nuk iu përgjigjët; qendrat e karrierës dhe qendrat rinore, që në angazhimet e qeverisë socialiste në vitin 2013 kanë qenë 12. Çfarë po bëhet për qendrat e karrierës në çdo universitet? Gjithashtu, çfarë po bëhet për investimet në sportin elitare apo për kampionët, të cilët, sot nuk janë vetëm dy emrat që tha zoti Sinaj, janë të shumtë në Shqipëri? Pra, çfarë po bëjmë për t'i financuar në përpjekjet e tyre për të arritur rezultate dhe që më pas kthehen edhe në ambasadorët më të mirë të vendit tonë nëpër botë?

Besa Shahini – Po e filloj nga pyetja e fundit. Ne jemi të limituar nga baza ligjore që na mundëson shpenzimin e buxhetit të sportit. Besoj se është një temë që do të diskutohet në takimet që po bëjmë në kuadër të pakos së sportit, ku po bëhen përjashtime nga taksa të ndryshme, do të stimulohet investimi në stadione e të tjera. Besoj se ky diskutim është i mirëpritur aty në mënyrë që të shikojmë si mund të zgjerohet gama e sportistëve elitare që mund të marrin shpërblime nga buxheti i shtetit. Për momentin kjo gjë nuk është e mundur, por mund të shikohet në vijim që të ndryshohet baza ligjore.

Për sa u përket qendrave të karrierës në universitete, institucionet e arsimit të lartë janë institucione autonome. Ato vendosin vetë për shërbimet që ofrojnë. Unë do të doja shumë të kishte qendra për orientimin në karrierë. Me sa di unë disa universitete i kanë, disa nuk i kanë, por nuk është tagër i Ministrisë së Arsimit të themelojë këto qendra brenda universiteteve, sepse nuk i kemi vartës direkt. Shkollat i kemi direkt në menaxhim, kurse universitetet nuk i kemi dhe nuk duhet t'i kemi. Ato kanë autonomi akademike.

Për sa u përket qendrave rinore, përsëri këtu kemi pasur një problem midis bashkive dhe ministrisë. Problemi, që ka dalë herë pas here dhe që po zgjidhet në vijim, ka të bëjë me kush investon dhe kush e ka në pronësi një hapësirë të caktuar. Kështu që, ne kemi pasur buxhetin, por qendrat rinore kanë qenë në pronësi të bashkive dhe ne nuk kemi arritur ta bëjmë investimin ashtu siç e kemi menduar. Besoj se do t'ua kalojmë bashkive dhe ne thjesht do të mbikëqyrim programet, siç bëjmë me shkollat, ku bashkia bën investimin infrastrukturor, menaxhon pjesën e prokurimit, kurse ne merremi me pjesën programatike të qendrës rinore. Është e vetmja zgjidhje, që ka funksionuar me shkollat dhe pse jo të mos e bëjmë edhe me qendrat rinore.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zonja Shahini për të gjitha përgjigjet e dhëna!

Ndërkohë, mendoj që do të përcjell këtu edhe opinionin e të gjithë kolegëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për çfarë?

Besoj se do të përcjell edhe atë që ju kërkuat pak më parë.

Përtej faktit që ju falënderoj për përgjigjet, unë mendoj që ju duhet të ushtroni presion shumë më të madh pozitiv në drejtim të institucioneve të tjera, qoftë ministrive të tjera, qoftë institucioneve të tjera, edhe të pushtetit lokal, që të mos marrim një përgjigje që nuk është kompetencë jona. Ndërkohë, ju jeni në tryezën e qeverisë kur merren vendimet dhe mund të ushtroni presionin tuaj pozitiv. Këtë e kam për tarifën e transportit, që është një problem i trashëguar, por besoj se është një shqetësim që e keni edhe ju për sa kohë që edhe mësuesit nuk mund të shkojnë, sepse tarifat janë shumë të ulëta, por edhe për pjesën e transportit të nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër, atje ku ne kemi klasat kolektive. Pra, presioni që duhet të bëni ndaj Ministrisë së Infrastrukturës është ai që në tavolinën ku uleni të negocioni dhe bashkëpunoni për ta zgjidhur.

Për sa u përket investimeve në infrastrukturën shkollore, e njëjta gjë mund të jetë kompetencë e bashkive për pjesën se si investimi në infrastrukturë do të duhet të alokohet brenda buxhetit të tyre, por në anën tjetër është një shqetësim juaji dhe joni. Kështu që, do të duhet përsëri presion pozitiv, përtej bashkëpunimit, për ta zgjidhur këtë çështje

Ju thoni që planifikimin e bëjnë ata në bazë të nevojave dhe më pas jeni ju që kryqëzoni të dhënat mbi nevojat që kemi. Ndryshimet demografike në Shqipëri kanë bërë që të kemi zona tërësisht pa nxënës dhe zona që nuk kanë një shkollë, edhe pse numri i banorëve është shumë i lartë. Jua thashë që në fillim që arrin në disa mijëra. Kështu që, siç morëm angazhim konkret për të gjetur zgjidhje për problematikat e arsimit të lartë nëpërmjet paktit për universitetin dhe pavarësisht mundësive të munguara financiare e zgjidhëm atë, pavarësisht kompetencave, nëse ishin të pushtetit vendor apo qendror, nëse ishin të universiteteve nëpërmjet autonomisë që i kemi dhënë nëpërmjet ligjit që arsimin e lartë, i zgjidhëm, të njëjtën gjë duhet të bëjmë edhe me këtë.

Përgjigjja duhet të jetë e njëjta edhe për pjesën e oborreve të shkollave, nëpërmjet nismës “shkollat qendra komunitare”. Unë besoj se të gjithë jemi shumë të lumtur që nëpërmjet dhënies me qira të ambienteve sportive për shfrytëzim gjatë pasdites ato ambiente do të sjellin të ardhura dhe do të kenë investime. Në anën tjetër, do të duhet që bashkëpunimi me të 61 bashkitë të jetë i tillë që të arrijmë të kemi të njëjtat investime kudo, sepse diferenca ndërmjet Tiranës dhe Kamzës është shumë e dukshme. Besoj se këtu ngre edhe shqetësimin e zotit Hysko. Nëse ju bashkë me ministrinë e tjera ushtroni presion pozitiv mbi pushtetin lokal, besoj se do t’u gjejmë

një zgjidhje këtyre probleme që nuk janë vetëm tonat, por të të gjithëve, e mbi të gjitha në përgjigje të shqetësimeve që kanë shumë prindër dhe qytetarë anembanë Shqipërisë.

Faleminderit! Këtu e mbyllim seancën dëgjimore për sot. Shihemi nesër.

Faleminderit, zonja Shahini!

Faleminderit sekretarit të Përgjithshëm dhe drejtoreshës së Përgjithshme për të gjithë prezantimin dhe përgjigjet!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti